

QENDRA NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË TRANZICIONALE

SERIA E STUDIMEVE TË RASTEVE TË NDJEKJEVE PENALE

**MËSIMET NGA VENDOSJA E GJYKATËSVE DHE PROKURORËVE NDËRKOMBËTAR NË
KOSOVË**

**E shkruar nga Tom Perriello dhe Marieke Wierda për Qendrën Ndërkombëtare për Drejtësinë
Tranzicionale**

Mars 2006

Rreth QNDT

Qendra Ndërkombëtare për të Drejtësinë Tranzicionale (QNDT) i ndihmon shteteve në lidhje me përcaktimin e llogaridhënies për krimet masive në të kaluarën si dhe për shkeljen e të drejtave të njeriut. Qendra punon në shoqëritë të cilat kanë dalë nga regjimi represiv apo konflikti i armatosur, si dhe në demokracitë e themeluara ku padrejtësitë historike ose shkeljet sistematike mbesin çështje të pazgjidhura.

Me qëllim të promovimit të drejtësisë, paqës, dhe pajtimit, zyrtarët qeveritar dhe avokatët joqeveritar sigurisht do ti konsiderojnë një llojllojshmëri të qasjeve të drejtësisë tranzicionale përfshirë zgjidhjet gjyqësore dhe jogjyqësore ndaj krimeve dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut. QNDT ndihmon në zhvillimin e qasjeve të integruara, gjithpërfshirëse, dhe të lokalizuara për drejtësinë tranzicionale që përbëhen prej pesë elementeve kyçe: ndjekja penale e kryesve, dokumentimi dhe pranimi i shkeljeve nëpërmjet mjeteve jogjyqësore si janë komisionet për të vërtetën, reformimimi i institucioneve të cilët kanë bërë shkelje, dhenia e kompensimit viktimave, dhe ndihma proceseve të pajtimit.

Qendra është e dhënë pas ndërtimit të kapaciteteve dhe në përgjithësi ndaj forcimit të fushës së re të drejtësisë tranzicionale dhe bashkëpunon ngushtë me organizatat dhe ekspertët nëpër tërë botën. Duke punuar në terren nëpërmjet gjuhëve vendore, QNDT jep informata krahasuese, analiza ligjore dhe të politikave, dokumentim, dhe hulumtim strategjik për gjyqësorin dhe institucionet e kërkimit të së vërtetës, organizatave joqeveritare, qeverive dhe të tjerë.

PËRMBAJTJA

Mësimet nga vendosja e Gjykatësve dhe Prokurorëve Ndërkombëtar në Kosovë

Përmbledhje e përfundimeve

- I. Hyrje
 - A. Histori e shkurtër e konfliktit
 - B. Themelimi i UNMIK-ut
- II. Themelimi i Tribunaleve Ndërkombëtare
 - A. Qasja e UNMIK-ut në Sundimin e Ligjit
 - B. Propozimi për Gjykatën Kosovare për Krimet e Luftës
- III. Themelimi i Kolegjeve Ndërkombëtare
 - A. Mekanizmat shkrehës për Kolegjet e Rregullorës 64
 - B. Programi i Gjykatësve Ndërkombëtar
 - C. Prokurorët Ndërkombëtar
- IV. Strategjia prokuroriale dhe çështjet e zgjedhjes së rasteve
 - A. Mungesa e kriterëve për kalim të rasteve
 - B. Shqetësimet në lidhje me pavarësinë
 - C. Mungesa e bashkëpunimit nga Serbia
 - D. Përmirësimet strukturale në sistemin e GJN
- V. Korniza Ligjore
- VI. Mbrojtja dhe çështjet e gjykimit të drejtë
- VII. Administrata gjyqësore dhe mbrojtja e dëshmitarëve
- VIII. Çështjet e shpenzimeve dhe efikasitetit
- IX. Marrëdhënia me TPNJ dhe mekanizmat tjerë të drejtësisë tranzicionale
- X. Informimi publik, perceptioni publik, dhe pronësia
- XI. Trashëgimia
- XII. Përfundimet

STUDIM RASTI I GJYKATAVE HIBRIDE

MËSIMET NGA VENDOSJA E GJYKATËSVE DHE PROKURORËVE NDËRKOMBËTAR NË KOSOVË¹

5 Mars 2006

Ky rast studimi synon të ofroj informata bazë dhe analizë të politikave mbi vendosjen e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar në Kosovë, program i cili u themelua nga Misioni i OKB në Kosovë (UNMIK) në vitin 1999. Është pjesë e serisë që ka për qëllim dhëniën e informative dhe analizave të politikave dhe çështjeve praktike me të cilat ballafaqohen gjykatat hibride. Në Kosovë, gjykatat hibride janë themeluar kur kapacitetet ndërkombëtare u kyçën në sistemin ligjor vendor. Mësimet që mund të merren nga kjo përvojë janë ndarë në këto fusha:

- Histori e shkurtër e konfliktit në Kosovë
- Pasqyra e themelimit të programit të gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar (GJPN)
- Përshkrimi i programit të GJPN
- Strategjia prokuroriale dhe zgjedhja e rasteve
- Korniza ligjore
- Administrata e gjykatave dhe mbrojtja e dëshmitarëve
- Shpenzimet dhe efikasiteti
- Marrëdhënia me Gjykatën Ndërkombëtare Penale për ish Jugosllavinë dhe mekanizmat tjerë të drejtësisë tranzicionale
- Informimi publik, perceptioni i publikut, dhe pronësia
- Strategjia dalëse dhe trashëgimia

Qëllimi i këtij studimi është të sigurojë informata themelore, disa nga të cilat nuk janë gjërësisht të disponueshme, në këto fusha për ti udhëhequr hartuesit e politikave dhe akterët kryesor në themelimin dhe implementimin e mekanizmave të ngjashëm. Studimi të rasteve të ngjashme janë zhvilluar në Sierra Leone dhe Timorin Lindor.

Përmbledhje e përfundimeve

Kosova po hyn në vitin e gjashtë pas konfliktit intensiv etnik dhe diskriminimit të gjatë sistematik dhe kanë kaluar pesë vite që nga kyçja e ndërkombëtarëve në sistemin ligjor të saj. Krijimi i sistemit të gjykatësve ndërkombëtar (GJN) dhe prokurorëve ndërkombëtar (PN) në Kosovë duhet të kuptohet si një seri e zhvillimeve reaktive për nevojat e realitetit politik të situatës së pas konfliktit, në dallim nga ndonjë iniciativë strategjike dhe të planifikuar të drejtësisë tranzicionale për tu marrë me krimet e së kaluarës. Ky sistem ka bërë përparime të kufizuara dhe kontributet e tij kanë qenë të kufizuara nga shqetësimet e vazhdueshme në lidhje me sigurinë, shqetësimet lidhur me pavarësinë, planifikimin ad-hoc, dhe implementimin e dobët duke përfshirë edhe mungesën e ndonjë plani konkret për dorëzim të përgjegjësive.

¹Ky studim rasti është përpiluar nga Tom Periello dhe Marieke Wierda. Laura Dickinson ndihmoi në draftin e hershëm. Tom Periello udhëtoi për Kosovë në Nëntor 2003 për qëllime të këtij studimi. Pikëpamjet e prezantuara këtu janë të autorëve dhe jo të QNDT. Jemi falënderues Richard Rogers, Ayumi Kusuafuka, Mark Freeman, Anie Bird dhe Vita Onwuasonaya për ndihmën e dhënë në plotësimin dhe shqyrtimin e këtij studimi.

- *Efekti.* Përderisa shumëkush ka pritur që kyçja e kapaciteteve ndërkombëtare në sistemin ligjor në Kosovë nëpërmjet programit të GJPN do të ketë efekt më të gjërë, deri tani, efekti i programit është kufizuar vetëm me zëvendësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve vendor, në vend të ngritjes së kapaciteteve vendore. Faktor kyç ka qenë përjashtimi i akterëve vendor nga çështjet e përcaktimit të politikave në lidhje me drejtësinë. Në fakt, programi i GJPN funksionon si një sistem paralel me fokus të veçantë në rastet e ndjeshme, duke përfshirë krimin e organizuar, trafikimin e drogës ose korrupsionin, të kryer nga rrjetet që mbështeten nga klanet e fuqishme në Kosovë, të cilat gjykatësit vendor hezitojnë ti gjykojnë vet.
- *Legjitimiteti.* Përderisa sistemi i GJPN ka ngjallur një nivel të besimit në sistemin ligjor, kjo ka të bëjë më tepër në rastet e gjykuara nga ndërkombëtarët, e jo aq në përgjithësi për sistemin vendor. Profesionistët ligjor vendor pajtohen që programi i GJPN ka qenë i domosdoshëm dhe që vazhdon që të shërbejë si një qëllim i vlefshëm, por që nevoja e vazhdueshme për ndërkombëtarë mund të shkaktoj humbjen e besimit në sistemin ligjor vendor. Poashtu, vendorët kanë qenë të përjashtuar nga dizajnimi i programit dhe vendimet kyçe të marra gjatë implementimit. .
- *Pavarësia.* Përderisa programi i GJPN dhe përpjekjet individuale të ndërkombëtarëve mund të gëzojnë një masë kredibiliteti në Kosovë, diskrecioni i gjërë i ekzekutivit të UNMIK-ut mbi çështjet e gjyqësorit ka mjegulluar perceptcionin e pavarësisë dhe ka qenë një pengesë në themelimin e respektit për ligjin. Një kornizë e mirëfilltë e cila do ti sqarojë kufijtë e këtyre fuqive do të ndihmonte në zvogëlimin e perceptcionit të arbitraritetit dhe ndërhyrjeve të panevojshme.
- *Drejtësia.* Përderisa GJPN kanë ndihmuar në sigurimin që drejtësia të arrihet në raste individuale, kyçja e tyre nuk ka shpjer përgjithësisht të arrihet masa e drejtësisë në gjykime. Korniza ekzistuese ligjore është komplekse dhe kërkon trajnim të vazhdueshëm të profesionistëve ligjor vendor dhe ndërkombëtar për të dhënë vendime më kualitative. Aplikimi i drejtëpërdrejtë i Konventës Europiane mbi të Drejtat e Njeriut, gjatë kohës, mund të ketë ndikim pozitiv mbi drejtësinë. Mirëpo, OSBE-ja e cila e monitoron procesin vazhdon të gjejë se përmirësimet janë të duhura në gjykatat vendore në fushat kyçe.² Perceptimi i drejtësisë vazhdon të dallohet përgjatë vijave etnike. Për më tepër, mungesa e çfarëdo lloji të strategjisë proaktive nga ana e UNMIK-ut e ka penguar transparencën e programit të GJPN, dhe Misioni ka humbur mundësitë për ti dhënë formën perceptimeve dhe pritjeve.
- *Efikasiteti i përgjithshëm.* Numri i gjykimeve në Kosovë është i krahasueshëm me ato të sistemeve tjera vendore. Përderisa disa nga gjykatësit dhe prokurorët vendor komentojnë se përfshirja e ndërkombëtarëve në gjykim i ka zgjatur gjykimet, një procedurë penale më e zgjatur dhe më e kujdesshme mund të shihet si e dobishme.
- *Trashëgimia.* Edhe pse sistemi i GJPN nuk ka dështuar sa i përket numrit të përgjithshëm të gjykimeve, ai mund të shiqohet si joefikas nëse nuk rezulton në ndikim sistematik sa i përket trashëgimisë. Në anën tjetër, pritjet nga ajo se sa mundet të arrihet në ndryshime sistematike për gjashtë vite duhet të jenë realiste. Mirëpo, është qenësore që tash e tutje të bëhen përmirësime për të mundësuar ndryshime sistemore.

Burimet jo të mjaftueshme dhe gjetja e stafit ndërkombëtar të kualifikuar (dhe trajnuar) janë pengesa të mëdha, edhe pse kjo është ndoshta produkt i mënyrës në të cilën GJPN evoluoi dhe u zhvillua. Disa do të thonin se një sistem me i centralizuar i kapaciteteve ndërkombëtare mund të ketë shmangur disa nga këto probleme duke i përmirësuar kushtet e shërbimit dhe duke i bërë ndërkombëtarët të ndihen më pak të izoluar. Të tjerët mund të vënë në pah dobietë nga shpërndarja e ndërkombëtarëve nëpër tërë sistemin vendor, edhe pse dobietë nga ndërtimi i kapaciteteve nuk janë maksimalizuar, dhe bashkëveprimi në mes të ndërkombëtarëve dhe vendorëve ka mund të jetë më strategjik.

² Shih, p.sh. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), Seksioni i Monitorimit të Sistemit Juridik (SMSJ), òShqyrtimi i Sistemit të Drejtësisë Penale, (Prill 2003 ó Tetor 2004) mbi Krimin, Paraburgimin dhe Dënimin.

Vëzhguesit kanë parë se kapaciteti vendor në Kosovë për gjykimin e rasteve komplekse ose politikisht të ndjeshme mbetet i kufizuar. Sistemi i GJPN në Kosovë do të duhet të mbahet në një të ardhme të konsiderueshme. Kjo nuk ndihmon shumë rritjen e besimit në sistemin ligjor vendor. Përfshirja e zgjatur ndërkombëtare mund të jep një rast të ri për kanalizimin e përpjekjeve për të qenë më strategjik. Do të duhej të dizajnohet një qasje e cila është më e orientuar në transferin e aftësive dhe dorëzimit eventual të përgjegjësive, për të punuar për strategjinë e përfundimit të programit të GJPN.

Profesionistët ligjor kosovar duhet të jenë pjesë përbërëse e dizajnit të strategjisë, duke e ndryshuar kulturën e tanishme të mungesës së konsultimeve. Po ashtu është me rëndësi që hartuesit ndërkombëtar të politikave fillojnë nëpërmjet një informimi publik të përkushtuar dhe edukimit të komunitetit ti përqëndrojnë përpjekjet e tyre për të siguruar njohjen më të madhe të opinionit publik me kufizimet me të cilat përballlet ky sistem. Të gjitha nga këto hapa janë të duhura për të konsoliduar përpjekjet e konsiderueshme të komunitetit ndërkombëtar për të siguruar ndikimin afatgjatë.

MËSIMET NGA VENDOSJA E GJYKATËSVE DHE PROKURORË VE NDËRKOMBËTAR NË KOSOVË

I. HYRJE

A. Histori e shkurtë e konfliktit

Kosova është një teritor i vogël, në qendër të ish Republikës Federale të Jugosllavisë, e që kufizohet me Maqedoninë (IRJM), Shqipërinë, dhe Serbinë dhe Malin e Zi. Që nga konflikti, në bazë të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 të datës 10 Qershor 1999, Kosova u përcaktua si pjesë autonome e Serbisë dhe Malit të Zi (në kuadër të shtetit të Serbisë) nën administrimin e Kombeve të Bashkuara. Kosova ka popullatë prej përafërsisht 1.9 milion, prej të cilëve përafërsisht 90 përqind janë shqiptarët etnik.³ Po ashtu rreth 550 000 Kosovar mendohet të jetojnë në diasporë, më së tepërmi të koncentruar në Gjermani, Zvicër dhe Serbi.⁴ Nga popollata e tërësishme 60 përqind jetojnë në vise rurale, dhe përafërsisht 400 000 banorë jetojnë në kryeqytetin Prishtinë/Pri-tina.⁵ Kosova e ka popullatën më të re në Europë, me moshë mesatare prej 22.5. Për më tepër, është një nga teritorët më të varfra në Europë. Ekonomia ka qenë e shkatëruar gjatë luftës. Të ardhurat vjetore për kokë banori janë përafërsisht 1000 Euro për kokë banori.

Tensionet etnike në Kosovë janë të simbolizuara në mitet serbe të lidhura me Betejën e Kosovës në 1389, gjatë së cilës gjoja forcat serbe luftuan fisnikërisht dhe humbën prej forcave turke, me të cilat shqiptarët zgjodhën aleancë. Përderisa historianët në përgjithësi përfundojnë se fraksionë të ndryshme serbe dhe shqiptare luftuan në të dy anët e konfliktit, legjenda serbe që nga ajo kohë ka mbetur si një thirrje për bashkim e nacionalistëve⁶. Në shekujt në mes të Betejës së Kosovës dhe viteve të vonshme të 1980, shumë nga serbët migruan në veri në Serbi, dhe një numër në rritje i shqiptarëve të fesë myslimane emigruan nga malet e Shqipërisë. Kur Serbia fitoi pavarësinë në vitin 1878, Kosova mbeti pjesë e Perandorisë Osmane. Në vitin 1912, serbët dhe forcat tjera Europiane dëbuan turqit, duke i çliruar shumë serbë brenda Kosovës por po ashtu duke i masakruar shumë ÷kolaboracionistë shqiptarë. Për katër dekadat e ardhshme, Kosova ndërroi pushtete, dhe me ardhjen e regjimit të ri, grupi etnik që vinte në pushtet zakonisht bënte një hakmarrje të tmerrshme ndaj grupeve tjera.

Në vitin 1974, Tito i dha Kosovës një autonomi të ngjashme ó por që dallonte ó nga ajo që gëzohej nga gjashtë shtete që përbënin federatën e ish Jugosllavisë. Kjo dykuptueshmëri e këtij sovraniteti krijoi rritje të tensionit pas vdekjes së Titos. Kosova përbëhej nga përafërsisht 90 përqind shqiptar të Kosovës, por minoriteti serb i Kosovës pretendonte lidhjet historike. Popullata serbe e Kosovës është e koncentruar në disa komunitete kyçe (kryesisht enklava), duke përfshirë për shembull pjesën veriore të Mitrovicës, dhe ata po ashtu pretendojnë disa monumente religjioze në Kosovë, si Patrikana e Pejës, si historikisht vitale.

Slllobodan Millosheviqi u zgjodh lider i Partisë Komuniste të Serbisë në vitin 1987 dhe u zgjodh President i Serbisë në vitin 1989 mbi një platformë nacionaliste që nënkuptonte kontrollin mbi Kosovën si parim qëndror.⁷ Në qershor të vitit 1989 dhe në 600 vjetorin e Betejës së Kosovës, Millosheviqi mbajti një

³ Enti Statistikor i Kosovës, ÷Kosova dhe popullata e sajë, version ii përmirësuar (5 Qershor 2003), qasja në www.sok-kosovo.org/pdf/population/Kosovo_and_its_population.pdf.

⁴ OKB vlerësojnë se përafërsisht 110,000 serb të Kosovës janë persona të zhvendosur (IDP) në Serbi, derisa Beogradi thotë se ky numër është rreth 250,000 (Mbi këtë thënie të Beogradit lidhur me IDP shih www.kc.gov.yu/C-ingleski/aktuelno/program_povratka.html.)

⁵ Shih raportin e UNDP në www.kosovo.undp.org/HDR/hdr.htm.

⁶ Noel Malcolm, ÷Beteja dhe Miti, ÷Kosova: Një Histori e Shkurtë , New York: HarperPerennial, 1999, faqe 58680.

⁷ Para 300,000 pjesëmarrësve në Beograd në Nëntor 1988, Millosheviqi tha, ÷Cdo popull ka një dashuri e cila ja ngroh zemrën përgjithmonë. Për Serbinë , kjo është Kosova. ÷ Prokurori kundër Millosheviq et al., Rasti ICTY ó 99 ó 37 ó PT, n.14.

miting të madh afër Prishtinës për të festuar kontrollin e Serbisë mbi Kosovën, një proces të cilin ai e filloi vite më parë. Millosheviqi foli për betejat e ardhshme,⁸ si përpjekje e parë e tij që të konsolidojë kontrollin mbi Jugosllavinë dhe ti vendosë minoritetin serb në kuadër të ÷Serbisë së Madhe⁹ Në esencë, ai lajmëroi përmbysjen e statusit autonom të Kosovës..

Gjatë viteve 1990, autoritetet serbe e sunduan Kosovën me represion dhe dhunë. Diskriminimi ishte i përhapur dhe shumë shqiptar janë pushuar kolektivisht nga puna. Liderët shqiptar të cilët u shkarkuan nga pushteti në vitin 1989 në fillim rezistuan në mënyrë paqësore duke e krijuar qeverinë paralele në egzil. Mirëpo, të tjerë shqiptar të Kosovës u bashkuan dhe formuan Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dhe nga vera e vitit 1998, tensionet në mes të UÇK-së dhe autoriteteve serbe eskaluan në një konflikt të gjërë të armatosur.

Forcat serbe vazhdimisht u përgjigjën sulmeve të vogla të UÇK-së në pozicionet serbe me forcë të tepruar, duke lansuar ofensive qeveritare për ta shkatërruar mbështetjen civile për kryengritësit. Forcat qeveritare sulmuan civilë, në mënyrë sistematike shkatërruan qytete, dhe dëbuan qindra mijëra banorë nga shtëpitë e tyre. Si hakmarrje, civilët serbë kanë qenë viktimë të kidnapimeve, rrahjeve dhe ekzekutimeve nga ana e forcave paramilitare të shqiptarëve etnik si ishte UÇK-ja, e cila po ashtu kishte në shënjestër shqiptarët etnik të cilët ishin të dyshuar për bashkëpunim me serbët.¹⁰

Për tetë muajt e parë të vitit 1998, konflikti i brendshëm në mes të qeverisë dhe UÇK-së rezultoi në përafërsisht 2000 viktimë civile të shqiptarëve.¹¹ Armëpushimi i muajti tetor solli vëzhguesit e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) si pjesë e Misionit Verifikues në Kosovë, por incidentët e dhunshme vazhduan. Më pas, më 15 janar 1999, paramilitarët serb sulmuan fshatin Reçak, duke vrarë 45 persona. Human Rights Watch raportoi se edhe pse sulmi ka mund të jetë i provokuar nga prita që UÇK-ja i beri tre policëve serb disa ditë para kësaj, forcat qeveritare u përgjigjën duke vrarë civil pa dallim, duke torturuar të burgosurit, dhe duke bërë ekzekutime masive¹². Pas masakrës së Reçakut, bashkësia ndërkombëtare filloi të rrisë presionin mbi Serbinë.

Bisedimet në shkurt dhe mars të vitit 1999 në Rambuje dështuan ta zgjedhin statusin e Kosovës nëpërmjet mjeteve diplomatike. Si pasojë, forcat paramilitare serbe hynë në një kampanjë të plotë të spastrimit etnik kundër popullatës civile, duke vrarë shumë dhe duke shkaktuar zhvendosje masive që detyroi rreth 850.000 shqiptar të Kosovës që të ikin nga krahina. Më 24 mars, NATO filloi fushatën e bombardimeve ajrore kundër forcave Serbe e cila zgjati 11 javë. Gjatë bombardimeve spastrimi etnik u intensifikua.

Më 27 maj 1999, në mes të luftimeve dhe me kundërshtim të anëtarëve të trupit diplomatik, Prokurorja e Tribunalit Ndërkombëtar për ish Jugosllavi (TNPJ), Louise Arbour, e shpalli aktakuzën kundër Sllobodan

⁸ Id.

⁹ Shih Noel Malcolm, ÷Kosova pas vdekjes së Titos (1981-1997), ÷Kosova: Një Histori e shkurtë, supra note 6, fq 340-350 (spjegov se si kontrolli i tij mbi Kosovën do të ndryshojë balancin e votimit të shteteve federale brenda Jugosllavisë).

¹⁰ Shih në përgjithësi Amnesty International, Raporti Vjetor 2000, Republika Federale e Jugosllavisë, shih www.web.amnesty.org/web/, Human Rights Watch, Raporti Botëror 1999, Republika Federale e Jugosllavisë, shih www.hrw.org/worldreport99/europe/yugoslavia.html; Hansjorg Strohmeyer, ÷Kolapsi dhe Rindërtimi i Sistemit Gjyqësor: Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Timor Lindor, ÷95 Am.J. Int'l L. 46, 2001; Buroja për Demokraci, Të Drejtat e Njeriut, dhe Puna, Depatamenti i Shtetit të SHBA, Raportet për praktikën e të drejtave të njeriut në shtete 1999, Serbi dhe Mali i Zi 23 Shkurt 2000.

¹¹ Human Rights Watch, ÷Republika Federale e Jugosllavisë: Zhvillimet e të Drejtave të Njeriut 1999, ÷shih www.hrw.org/er2k/Eca-26.htm.

¹² Id.

Milloseviqit dhe të tjerëve për krime kundër njerëzimit dhe shkeljes së ligjeve të luftës.¹³ Aktakuza kishte të bënte ekskluzivisht me krimet e kryera në Kosovë nga janari deri në maj të vitit 1999.¹⁴

Fushata e bombardimeve të NATO-s përfundoi me marrëveshje e cila parashihte tërheqjen e forcave ushtarake dhe policore të Serbisë nga Kosova brenda 11 ditëve.¹⁵ Më 10 Qershor 1999, një ditë pas suspendimit të bombardimeve të NATO-s, Këshilli i Sigurimit i OKB-së adoptoi Rezolutën 1244 (1999), e cila e themeloi Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe e shëndroi Kosovën në protektorat të OKB-së.¹⁶ Në frymën e Rambujes dhe duke marrë parasysh shqetësimet ndërkombëtare mbi vendosjen e precedentit për vetëvendosje etnike, Rezoluta 1244 i shmanget pyetjes së statusit të Kosovës duke i reafirmuar kufitë ekzistues territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) dhe bën thirrje për òautonomi substanciale dhe òvetëqeverisje kuptimplotë të Kosovës.¹⁷

Në gjashtë vitet pas përfundimit të konfliktit, Kosova ka qenë nën administrim të OKB-së. UNMIK-u ka qenë i kyçur në ndërtimin e institucioneve shtetërore, duke përfshirë legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin, në nivel qëndror dhe komunal. Mirëpo, serbët e Kosovës i mbajnë strukturat e tyre paralele, posaçërisht për edukim dhe shëndetësi, dhe refuzojnë të marrin pjesë në strukturat politike që janë themeluar, duke mbajtur lidhje të ngushta me Beogradin. Shqetësime të ndjeshme mbesin lidhur me aftësinë e autoriteteve vendore për mbrojtjen e pakicave, posaçërisht pas trazirave të marsit 2004.

Ekonomia mbetet e dobët, dhe politikat nacionaliste janë prezente në Kosovë. Sllogani òJo negociata ó Vetëvendosje ò gjendet në shumë mure. TNPJ ka akuzuar ish kryeministrin e Kosovës dhe ish komandantin e UÇK-së Ramush Haradinaj. Shume ish liderë të UÇK-se mbesin me ndikim të madh, dhe politika në mes të klaneve të fuqishme e kombinuar me krimin e organizuar dhe korrupsionin krijon një ndjenjë të pandëshkueshmërisë dhe venë presion mbi gjyqësinë vendore. Të gjithë këta faktorë bashkëveprojnë për të krijuar një rreth jo mikëpritës për sistemin e drejtësisë.

Në tetor 2005, raporti i përgatitur nga i Dërguari i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm Kai Eide u publikua dhe rekomandonte që të fillohet procesi për të përcaktuar statusin final të Kosovës.¹⁸ Martti Ahtisaari u emërua si Kryenegociator i OKB-së, dhe në nëntor ai bëri vizitën e parë në regjion për ti hapur bisedimet. Çështja e statusit do të jetë e vështirë për tu zgjidhur. Përderisa shumica e shqiptarëve të Kosovës besojnë së e meritojnë pavarësinë, shumica e serbëve brenda dhe jashtë Kosovës e kundërshtojnë fuqimisht atë.

B. Themelimi i UNMIK-ut

UNMIK-ut iu besua një mandat i gjërë, duke përfshirë promovimin e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut.¹⁹ Misioni përbëhet nga katër komponente (Shtylla), çdonjëra e udhëhequr nga Zëvendës Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (ZPSSP). Tre organizata ndërkombëtare veprojnë në këto katër shtylla.

¹³ òPresidenti Milloseviq dhe Katër Zyrtarë të Lartë të RFJ u akuzuan për Vrasje, Persekutim dhe Deportim në Kosovë, òKomunikata për Shtyp JL/PIU/403-E, Hagë, 27 Maj 1999.

¹⁴ Edhe pse TPNJ u krijua më 1993, Milloseviq akoma nuk ishte akuzuar për ngjarjet në Bosne dhe Hercegovinë dhe Kroaci.

¹⁵ Shih Amnesty International, Raporti Vjetor 2000, supra note 10; Human Rights Watch, Raporti Botëror 1999, supra note 10; Strohmeyer, òKolapsi, ò supra note 10; Biroja për Demokraci, të Drejtat e Njeriut, dhe Punë, Departamenti i Shtetit i SHBA, Raporti mbi praktikën e të drejtave të njeriut në shtete 1999, supra note 10.

¹⁶ Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1244, UN SCOR, Sesioni i 54. 4011th mtg., UN Doc. S/RES/1244 (1999).

¹⁷ Rezoluta e OKB 1244.

¹⁸ UN Doc. S/2005/635, me Annex, òShqyrtim i përgjithshëm i situatës në Kosovë. ò

¹⁹ Rez. e OKB. 1244/1999, supra note 11, par. 11.

Shtylla I, òPolicia dhe Drejtësia,ò²⁰ u themelua në maj 2001 për të themeluar sundimin e ligjit, përfshirë forcat policore dhe themelimin e gjyqësisë dhe shërbimin korrektues. Kjo punë është drejtuar nga OKB. (Në vitin e parë të mandatit të UNMIK-ut, Shtylla I, ka qenë e fokusuar në Asistencën Humanitare nën shenjën e Komisionerit të Lartë për Refugjatë të OKB). Shtylla II, òAdministrata Civile, poashtu drejtohet nga OKB²¹ Shtylla III, òDemokratizimi dhe Ndërtimi i Institucioneve, ka për qëllim zhvillimin e shoqërisë civile dhe institucioneve të drejtave të njeriut, mediave, dhe partive politike. Kjo shtyllë udhëhiqet nga OSBE. Shtylla IV, òRindërtimi Ekonomik,ò udhëhiqet nga Bashkësia Europiane (BE).

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB (PSSP) është udhëheqësi i UNMIK-ut dhe ka òfuqi maksimale ekzekutive civileò²² që përfshinë autoritet ekskluziv ekzekutiv dhe legjislativ për òndryshimin, anulimin ose suspendimin e ligjeve ekzistuese për aq sa është nevojaò²³ dhe ònxjerrjen e akteve legjislative në formë të rregulloreve.ò²⁴ PSSP-ja po ashtu ka kompetenca për emërimin dhe shkarkimin e cilitdo person në administratën civile, përfshirë edhe gjyqësorin.²⁵

Përveç themelimit të administratës civile, Rezoluta 1244 po ashtu themeloi Forcën e Kosovës (KFOR), një forcë shumëkombëshe paqëruajtëse nën komandën e NATO-s e cila u ngarkua me sigurimin e òrendit dhe sigurisë publike deri në kohën kur një prezencë civile ndërkombëtare mund ta merr këtë detyrë.ò²⁶ KFOR-i vepron nën një strukturë komanduese unike e cila është e ndarë nga UNMIK-u.²⁷ Me fillim të marrjes së kontrollit mbi regjionin nga ana e UNMIK-ut, ishte e përhapur hakmarrja nga shqiptarët e drejtuar kundër serbëve të mbetur dhe atyre shqiptarëve që konsideroheshin si kolaboracionist. Për shembull, ka patur një valë të zjarrvënive të qëllimshme kundër shtëpive të serbëve përgjatë vendit dhe sulme nga shqiptarët, me indikacione të fuqishme për pjesëmarrje të UÇK-së.²⁸ Situata në qytetin e ndarë të Mitrovicës ka qenë posaçërisht e tensionuar.

Shumica nga policët, prokurorët dhe gjykatësit në Kosovë kanë qenë serb nga Kosova, sepse shqiptarët nga Kosova janë spastruar nga këto pozita gjatë fundit të viteve 1980 dhe fillimit të viteve 1990. Shqiptarët të cilët mbetën në pozitat e tyre në kohën e Millosheviqit pas luftës janë cilësuar si kolaboracionistë. Tërheqja krijoi një vakum sa i përket zbatimit të ligjit.²⁹ Rezoluta 1244 ofron autoritet

²⁰Shtylla e Policisë dhe Drejtësisë (Shtylla I) u themelua në Maj 2001 si Shtylla I e re. Në fund të fazës emergjente, Shtylla I (asistenca humanitare) kishte për qëllim dhëniën e ndihmës humanitare dhe ndihmën në kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda, nën udhëheqjen e Zyrës së Komisionerit të Lartë për Refugjatë të Kombeve të bashkuara, dhe përfundoi në vitin 2000. Shtylla I e re po ashtu përfshiu dy departamentet e zbatimit të ligjit dhe çështjeve gjyqësore, që kanë qenë pjesë e Shtyllës II të UNMIK-ut, Administrata Civile.

²¹Komponenta e policisë dhe gjyqësisë, Departamenti i çështjeve policore dhe të gjyqësis (më vonë i emëruar si Departamenti i Drejtësisë) të administratës civile nën Shtyllën II u transferuan në Shtyllën I të re, Policia dhe Drejtësia, më 24 Maj 2001. .

²² Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm para Këshillit të Sigurimit më 12 Qershor 1999, UN Doc. S/1999/779, para. 44.

²³ Id. para. 39.

²⁴ Id. para. 41.

²⁵ Id. para. 40.

²⁶ Id. para. 61.

²⁷ Brigadat shumëkombëshe (të cilat në fillim përfshinin forcat e NATO-s dhe ato Ruse) i nënshtrohen zinxhirit unik komandues nën autoritetin e Komandantit të KFOR-it..

²⁸ Human Rights Watch, Raporti Vjetor 1999, supra note 10. Një zyrtar për të drejtat e njeriut në Pejë tha se 100 përqind të shtëpive të Serbëve në atë rreth janë shkatëruar gjatë kësaj periudhe. Të tjerët raportojnë se 250,000 Serb dhe minoritetet tjera janë zhvendosur pas Qershorit 1999. Shih Grupi Ndërkombëtar i Krizave, òGjetja e Balancitò 12 Shtator 2002, fq.3.

²⁹ Shih Michael E. Hartmann, òGjykatësit dhe Prokurorët Ndërkombëtar në Kosovë: Model i ri për paqëruajtje pas konfliktit,ò Instituti për Paqe i `Shteteve të Bashkuara, Tetor 2003. Shih po ashtu David Marshall dhe Shelley Inglis, òShfuqizimi i Drejtësisë së bazuar në të Drejtat e Njeriut në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë,ò Harvard Human Rights J., Pranverë 2003, fq 101, shih në

eksplicit për sigurimin e òrendit dhe qetësisë publike³⁰ dhe themelimin e òforcës policore vendore³⁰ por nuk përmend autoritetin gjyqësor. Mirëpo, ri-themelimi i ligjit dhe rendit në krahinë ka qenë prioritet për UNMIK-un.

Në mars 2004, Kosova përjetoi trazira të dhunshme anti-serbe, dhunën më të rëndë ndëretnike që nga viti 1999. E nxitur nga informacioni i lajthitur se serbët janë përgjegjës për mbytjen në lumë të tre fëmijëve shqiptarë,³¹ trazirat u inicuan për dëbimin e komunitetit serb, rom dhe ashkali nga Mitrovica. Dhuna rezultoi me 21 viktima (të ndarë gati barabartë në mes të komunitetit serb dhe atij shqiptar),³² më tepër se 900 të plagosur (më tepër se 20 rëndë); mbi 700 shtëpi të serbëve, romëve dhe ashkalive; deri më 10 ndërtesa publike, 30 kisha serbe, dhe dy manastire të dëmtuara ose të shkatëruara; dhe 4,500 serb nga Kosova të zhvendosur.³³ Trazirat zbuluan situatën e vazhdueshme të pasigurtë në Kosovë, përfshirë këtu edhe ndarjet etnike dhe ndjeshmërinë e vazhdueshme të popullatës pakicë, si dhe pakënaqësitë e popullatës shumicë me mungesën e progresit.

II. THEMELIMI I TRIBUNALEVE NDËRKOMBËTARE

A. Qasja e UNMIK-ut ndaj Sundimit të Ligjit

Krijimi i kolegeve hibride në Kosovë ka qenë përgjigje ndaj nevojave urgjente në terren. Mandati i UNMIK-ut për mbajtjen e paqes dhe sigurisë në territor përfshinte direktivën për mbajtjen e òrendit dhe qetësisë publike, duke përfshirë themelimin e forcës policore vendore dhe në të njejtën kohë edhe vendosjen e personelit policor ndërkombëtar për të shërbyer në Kosovë.³⁴ Përderisa zyrtarët e OKB e interpretuan këtë si mandat për ri-themelimin e sektorit të drejtësisë në përgjithësi dhe, në veçanti, për të kërkuar llogaridhënie për krimet e luftës dhe krime tjera të kryera gjatë dhe pas konfliktit, teksti i rezolutës ka qenë i zbehët sa i përket kësaj pike.³⁵

Detyra për ri-themelimin e sundimit të ligjit dhe drejtësisë penale në Kosovë ndahet në mes të OKB dhe OSBE-së. Nën strukturën e UNMIK-ut në shtyllën I (Policia dhe Drejtësia), Departamenti i Drejtësisë (DD) dhe policia e UNMIK-ut janë përfshirë në një administratë për ta maksimalizuar koordinimin e hetimeve penale. Me mandat parësor për ndërtimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe multi etnik, DD poashtu është përgjegjës për administrimin e shërbimit korrektues në Kosovë, duke siguruar qasje në drejtësi për të gjitha komunitetet dhe dhënien e ndihmës dhe shërbimeve të avokimit për viktima. Për shembull, forca e re policore e Kosovës, Shërbimi

www.law.harvard.edu/students/orgs/hrj/iss16/marshall.shtml (me shënim për vakumin gjyqësor nga Qershorió Dhjetor 1999 dhe aktivitetin kriminal që prodhoi, përfshirë dhunën etnike ndaj Serbëve dhe të Shqiptarëve të dyshuar për bashkëpunim).

³⁰ Rez. 1244, supra note 16, at 9(d), 11(i).

³¹ Hetimet në mbytjen e dy fëmijëve shqiptar në Çabër, të udhëhëqura nga prokurori ndërkombëtar, përfunduan se nuk ka dëshmi që tregojnë se të rinjtë Serb kishin rol në këtë aksident, edhe pse nuk e gjeti as shkaku e mbytjes së fëmijëve. BBC Monitoring Europe, òhetimet në mbytjen e fëmijëve shqiptar përfunduan, 28 Prill 2004, dhe òU gjet trup i fëmkiut të tretë Kosovar mbytja e të cilit nxitu trazirat e Marsit, ò 12 Qershor 2004.

³² Sipas zëdhënësit të UNMIK-ut Neeraj Singh në Prill 2004, nga 19 të vdekur të konfirmuar (në atë kohë) 11 ishin Shqiptar dhe 8 ishin serb.

³³ Për diskutim të detajuar të trazirave shih, Human Rights Watch, òDështimi për mbrojtje: Dhuna kundër Minoriteteve në Kosovë, ò Mars 2004, shih në hrw.org/reports/2004/kosovo0704/, dhe Grupi Ndërkombëtar i Krizave, òKolapsi në Kosovë, Raporti Europian Nr. 155, ò 22 Prill, 2004, shih në www.crisisgroup.org/home/index.cfm?id=3226&l=1.

³⁴ Rez. e KS 1244, supra note 16, at 11(i).

³⁵ Shih intervistë me zyrtar të OKB, Nëntor. 2003, që tregon për dobësinë e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit në çështjet të cilat kanë të bëjnë me sektorin e drejtësisë, në kundërshtim me mandatin mbi policinë.

Policor i Kosovës (SHPK), ka njësi të specializuara për dhënien e mbrojtjes dëshmitarëve të ndjeshëm, për të luftuar trafikimin me qenie njerëore, dhe të luftojë forma tjera të krimit të organizuar.

Puna me komunitetin ligjor vendor në promovimin e të drejtave të njeriut, zhvillimin e kapaciteteve ligjore, dhe ndërtimi i institucioneve ligjore është pjesë e përpjekjeve të OSBE-së si Shtylla e III. Në veçanti, OSBE-ja ka themeluar dhe mbështetur një sërë programesh dhe institucioneve për monitorimin dhe ndërtimin e kapaciteteve, posaçërisht Seksionin e Monitorimit të Sistemit Juridik (SMSJ). Ajo poashtu e monitoron sistemin e drejtësisë. Për më tepër, Qendra e Resurseve për Mbrojtjen Penale (QRMP), një organizatë joqeveritare (OJQ), u themelua për të mbështetur mbrojtësit; mbështetja i është dhënë edhe Odës së Avokatëve të Kosovës; Instituti Gjyqësor i Kosovës u krijua për ti trajnuar gjykatësit dhe prokurorët vendor; dhe Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit jep ndihmë në reformën e një mumri të çështjeve ligjore. Përgjegjësia për rindërtimin e sektorit të gjyqësisë dhe ndërtimin e kapaciteteve të akterëve vendor ndahet nga institucione të ndryshme. Udhëheqësit e Shtyllës I nuk e konsideruan ndërtimin e kapaciteteve si pjesë të mandatit të tyre.

Rindërtimi i sektorit të drejtësisë është një sfidë enorme e cila nuk përmbushet lehtë.³⁶ Pjesa më e madhe e infrastrukturës fizike të sistemit gjyqësor ó ndërtesat e gjykatave, libraritë ligjore, dhe mjetet - u shkatëruan ose u dëmtuan dukshëm gjatë konfliktit.³⁷ Ishte vështirë të gjenden avokatë dhe gjykatës vendor; shumica u larguan me tërheqjen e forcave serbe, dhe ata të cilët mbetën përgjithësisht refuzuan të shërbejnë nën UNMIK-un. Po ashtu, pak shqiptar të Kosovës patën eksperiencë ligjore, pasi që shumica ishin dëbuar nga gjyqësia në dekadën e kaluar,³⁸ edhe pse disa e vazhduan punën si avokat mbrojtës.³⁹ Mësimet në Fakultetin Juridik u mbanin vetëm në gjuhën serbe dhe provimi i jurisprudencës ofrohej vetëm në Beograd,⁴⁰ kështu që pjesa më e mirë e një gjeneratë të juristëve shqiptar kishte humbur.

Një çështje tjetër e rëndësishme ishte mungesa e kornizës ligjore. Një nga Rregulloret e para të UNMIK-ut, 1999/1, deklaronte se ligjet e ish-RFJ para vitit 1989, si dhe disa ligje të nxjerra në mes viteve 1989 ó 1999, vazhdojnë të aplikohen,⁴¹ përveç nëse përmbanin ndonjë element të diskriminimit etnik ose shkelnin ndonjë standard të së drejtës ndërkombëtare. Vendimi për ringjalljen e ligjeve të Serbisë të imponuara nga Millosheviqi pas vitit 1989 e ofendoi shumicën shqiptare dhe i armiqësoi anëtarët e komunitetit ligjor shqiptar, shumica nga të cilët ishin të njohur vetëm më ligjet para erës së Millosheviqit.⁴²

UNMIK-u po ashtu ishte nën presion sepse të paraburgosurit që dyshoheshin të kenë kryer krime ishin duke i stërngarkuar burgjet pa ndonjë shpresë për gjykim të shpejtë. I shkatërruar nga konflikti dhe vitet e

³⁶ Për një shqyrtim të përpjekjeve për të themeluar sundimin e ligjit në Kosovën e pasluftës, shih Eëndy S. Betts, Scott N. Carlson, dhe Gregory Gisvold, *Administrata Tranzicionale pas konfliktit në Kosovë dhe mësimet e nxjerra nga përpjekjet për themelimin e gjyqësisë dhe sundimit të ligjit*, *22 Mich. J. Int'l L.* 371, 2001; Jean-Christian Cady dhe Nicholas Booth, *Gjykatat e ndërkombëtarizuara në Kosovë: Nga perspektiva e UNMIK-ut*, *Tribunalet dhe Gjykatat e Ndërkombëtarizuara*, PICT, 2004; Hansjörg Strohmeyer, *Si të arrihet suksesi i Intervenimeve Multilaterale: Kombet e Bashkuara dhe Krijimi i Sitimeve të Drejtës Transitore në Kosovë dhe Timorin Lindor*, *Fletcher For. World Aff.*, 2001; Strohmeyer, *Kolapsi*, *supra* note 10.

³⁷ Betts, *id.* fq 376-377.

³⁸ Strohmeyer, *Kolapsi*, *supra* note 10, fq 53. Disa vëzhgues cekin se sistemi gjyqësor i kaluar ka qenë me një formë jo formale dhe jo transparente e referuar si *òdrejtësia nëpërmjet telefonit* (shih Hartmann, *supra* note 29, fq 5).

³⁹ Shih *òGjetja e Balancit*, *supra* note 28, fq 3.

⁴⁰ *Id.*

⁴¹ Ligji i aplikueshëm para 1989, kur Shqiptarët akoma punoni, ishte Ligji Penal i Kosovës (nga 1977), Ligji Penal i Jugosllavisë (1 Korrik 1977), dhe Ligji mbi Procedurën Penale i Jugosllavisë (30 Qershor 1977).

⁴² Betts, *supra* note 36, faqe 373-374. Shih po ashtu Marshall, *supra* note 29, fq 101. Intervista me disa avokatë Kosovar.

diskriminimit kundër pakicës etnike shqiptare, sistemi vendor gjyqësor nuk pati kapacitet për ti mbajtur këto gjykime, e as nuk konsideroheshin të jenë të paanshëm ndaj serbëve të cilët ishin të akuzuar për krime. Prokurori i TNPJ e bëri të qartë se tribunali mund ti gjykojë vetëm ata të cilët kanë kryer krime më të rënda në shkallë të madhe.⁴³ Përderisa të paraburgosurit vazhdonin të qëndronin në paraburgim, disa ceknin se paraburgimi i vazhdueshëm cenonte standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut. Frustrimi në mesin e popullatës së serbëve të Kosovës sa i përket dështimit të procesit gjyqësor mund të ketë kontribuar rritjes së dhunës ndëretnike.⁴⁴ Kombinimi i faktorëve të lartcekur përfundimisht solli grevën e urisë të paraburgosurve serb.

Kjo filloi që të shpie në një pikë kritike në dhjetor të 1999, kur afati prej gjashtë muaj paraburgim filloi të afrohej për shumë nga të paraburgosurit.⁴⁵ PSSP-ja në fillim u përgjegj duke e ndryshuar ligjin për të lejuar paraburgim në kohëzgjatje prej një viti, por kjo nuk bëri asgjë për ta zvogëluar numrin e të paraburgosurve.⁴⁶ Masat tjera në përdorim nga KFOR-i përfshinë të ashtuquajturën ombajtjen nga COMKFOR-i, procedurë për paraburgime jashtëgjyqësore që përdorej atëherë kur autoritetet e KFOR-it besonin që i paraburgosuri paraqet rrezik për rendin dhe sigurinë publike.⁴⁷ PSSP-ja po ashtu filloi ti përdorte të ashtuquajturat Paraburgime Ekzekutive të urdhëruara nga ai. Të dy masat u qortuan nga SMSJ i OSBE-së dhe nga tjerët si të paarsyeshme dhe në kundërshtim me normat ndërkombëtare.⁴⁸

B. Propozimi për Gjykatën Kosovare të Krimeve të Luftës dhe Krimeve Etnike

Për të adresuar ate që në mënyrë rapide u shëndërrua në krizë të gjyqësisë dhe llogaridhënies, në fund të vitit 1999 OKB dhe zyrtarët e shteteve anëtare, si dhe gjyqësia vendore, filluan bisedimet për krijimin e një gjykate penale në Kosovë.⁴⁹ Gjykata e propozuar, të cilës i referoheshin si Gjykata Kosovare për Krimet e Luftës dhe Etnike (KWECC),⁵⁰ duhej të ishte tribunal ad-hoc, i udhëhequr nga ndërkombëtarët, me seli në Prishtinë por i modeluar sikur TPNJ.⁵¹ Planifikimi për KWECC, i cili kur nuk u realizua, erdhi në një shkallë të avancuar. KWECC duhej të kishte juridiksionin primar me gjykatat vendore në Kosovë mbi shkeljet serioze të drejtës humanitare ndërkombëtare si dhe krimet tjera të rënda të kryera në bazë politike, etnike, ose fetare që nga 1 janari 1998, duke përfshirë: krimet e luftës, gjenocidin, krimet kundër njerëzimit, dhe krime tjera të rënda të kryera në bazë të racës, përkatësisë etnike, fesë, kombit, ose përkatësisë ndonjë grupi pakicë etnik ose politik. Nuk kishte ndonjë datë për përfundim të punës. Kjo

⁴³ Shih Carla Del Ponte, Prokurore e TPNJ, *o*Deklaratë mbi Hetimet dhe Aktakuzat e Krimeve të Kryera në Kosovë, *o*Hagë, 29 Shtator 1999.

⁴⁴ Shih Strohmeier, *o*Kolapsi, *o* supra note 10, fq 49. Kur UNMIK-u e nxorri Rregulloren e cila mundësonte paraburgimin më të gjatë të të pandehurve, SMSJ i OSBE-së erdhi në përfundim se rregullorja e re paraqet *o*shkelje të qartë të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut (KNDNJ) dhe të Paktit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave Civile dhe Politike (ICCPR). SMSJ i OSBE-së, *o*Kosova: Raporti nr.6: Zgjatja e afatit të paraburgimit dhe të drejtat e të paraburgosurve: jo ligjshmëria e Rregullorës 1999/26. *o* 29 Prill 2000.

⁴⁵ Hartman, supra note 29, fq 5.

⁴⁶ Id.

⁴⁷ Id.

⁴⁸ Për diskutim të mëtejme, shih SMSJ i OSBE-së, *o*Shqyrtimi i Sistemit të Drejtësisë Penale, *o*Shtator 2001 *o* Shkurt 2002, fq 45 *o* 51.

⁴⁹ Në raportin e parë të saj më 13 Dhjetor 1999, Komisioni Teknik Këshillëdhënës (KTK) për Shërbimet e Gjyqësisë dhe Prokurorisë, i cili u themelua në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/6 të datës 7 Shtator 1999, dhe i përbërë nga ekspertë ndërkombëtar dhe Kosovar, rekomandoi themelimin e tribunalit të tillë. Strohmeier, *o*Intervenimet Multilaterale, *o* supra note 36, fq 119. Anëtarët ndërkombëtar dhe vendor të KTK votuan njëzëri për krijimin e gjykatës së tillë. Misioni i SHB në Kosovë, *o*Raporti për vlerësimin e gjyqësisë në Kosovë, *o* Prill 2000, shih në pristine.usmission.gov/jud.pdf

⁵⁰ Emri i propozuar në fillim ka qenë Tribunali Kosovar për Krimet e Luftës dhe Krimeve Kundër Njerëzimit, por më vonë u emërua si KWECC.

⁵¹ Anëtarët vendor dhe ndërkombëtar të KTK votuan njëzëri për krijimin e gjykatës së tillë. Raporti për vlerësimin e gjyqësisë në Kosovë, supra note 49, fq 20.

nënkuptonte që cilido krim i rëndë që përfshinte cilëndo pakicë etnike mund të mbulohej nga juridiksioni i gjykatës.⁵² Përderisa KWECC do të kishte juridiksion simultan në raport me TPNJ,⁵³ tribunali do të kishte supremaci dhe KWECC to të fokusohej në kryesit e veprave më pak të njohur për të cilët TPNJ nuk kishte kapacitet për ti gjykuar.⁵⁴

Në bazë të propozimit, KWECC do të kishte kolegje të përbërë nga gjykatës ndërkombëtar dhe vendor.⁵⁵ KWECC do të punësonte gjykatës, prokuror dhe staf ndihmës shumetnik ndërkombëtar dhe vendor. Kryetari i gjykatës duhej të ishte ndërkombëtar. Staf lokal, përfshirë gjykatësit, prokurorët dhe personelin tjetër, do të siguroheshin nga Departamenti i Cështjeve Gjyqësore.⁵⁶ Nënkuptohej se personeli ndërkombëtar gjyqësor, si gjykatësit dhe prokurorët, do të emëroheshin nga shtetet apo organizatat.⁵⁷ Po ashtu, do të themeloheshin Njësia për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Zyra e Mbrojtjes.⁵⁸ KWECC do të duhej të fillonte punën në verën e vitit 2000, dhe kryetari i emëruar, Fernando Castanon, kishte arritur në Kosovë.⁵⁹ Pasi që PSSP-ja Bernard Kouchner e nënshkroi rregulloren, procesi i zgjedhjes së gjykatësve tjerë ndërkombëtar dhe vendor filloi.

Koncepti i KWECC shkaktoi disa shqetësime në mes të komunitetit ligjor të shqiptarëve të Kosovës për shkak të mundësisë të shterjes së mundshme që mund ti bëhet sistemit gjyqësor kosovar,⁶⁰ dhe komplikimeve potenciale për shkak të ekzistimit të një shtrese të re në mes të gjyqësisë vendore dhe TPNJ.⁶¹ Po ashtu, Oda e Avokatëve ka qenë skeptike për një tribunal ndërkombëtar i cili ka pak mundësi që të marrë në punë juristë vendorë. Disa nga ata të cilët kishin lidhje me partitë politike i frikësoheshin sistemit i cili ishte òshumë i pavarurò prandaj edhe kishte më tepër mundësi që ti ndjekë shqiptarët për krime lufte. Poashtu kishte frikë që KWECC do të acarojë tensionet etnike.⁶²

Në shtator të vitit 2000, ideja e KWECC u braktis.⁶³ Shtetet anëtare ishin të shqetësuara për shpenzimet e një gjykatë të tillë⁶⁴ dhe kishin frikë se do të ishte e pamundshme që të jepet siguria e nevojshme.⁶⁵ Një diplomat amerikan e quajti këte si një òpërplasje klasike në mes të idealizmit të OKB dhe cinizmit të

⁵² Misioni i SHBA në Kosovë (2000).

⁵³ Strohmeyer, òIntervenimet Multilateraleò supra note 36, fq 119.

⁵⁴ Id.

⁵⁵ UNMIK, òKosova: rindërtimi 2000,ò Prill 2000 shih në eëë.seerecon.org/kosovo/documents/reconstruction2000/index.html.

⁵⁶ Komunikatë për shtyp e UNMIK-ut, òAtmosferë Tensionuese në mbledhjen e Përbashkët të IAC dhe KTK: Tribunal i Hagës dhe Gjykata për Krime Lufte do të punojnë së bashku,ò 3 Qershor 2000, shih në www.unmikonline.org/press/mon/Imm030600.html.

⁵⁷ Id.

⁵⁸ Ky projekt përfshinte shpenzimet për sigurinë si dhe shpenzimet fillestare për mjete, si janë detektorët e metalit, kompjuterë, vetura të blinduara, dhe pajisje të zyrës. Shih òKosova: Rindërtimi 2000,ò supra note 55.

⁵⁹ Komunikatë për shtyp e UNMIK-ut, supra note 56.

⁶⁰ Disa zyrtarë të UNMIK-ut thanë se presioni do ta bëjë KWECC të jetë diskrecionist, dhe se do të ketë fuqi për ti zhvilluar kriteret e brendshme për zgjedhjen e rasteve. òRaporti për vlerësimin e gjyqësisë në Kosovë,ò supra note 49, fq 21.

⁶¹ John Cerone dhe Clive Baldwin, òSpjegimi dhe vlerësimi i sistemit të gjykatave të UNMIK-utò në Andre Nollkaemper Romano dhe Jann K. Kleffner et al., Gjykatat Penale të Ndërkombëtarizuara, Dhjetor 2004.

⁶² Michael A. Newton, òSimpozium hulumtues për Krimet e Luftës: Roli i Drejtësisë në Ndërtimin e Paqës: Një shiqim nga hendeku: roli i ushtrisë në arritjen e drejtësisë,ò Case Western Reserve J. Intð., Pranverë 2003, n100.

⁶³ Intervistë me zyrtar të OSBE-së, nëntor 2003; Cady supra note36, fq 52.

⁶⁴ Shpenzimet fillestare të gjykatës për gjashtë muajt e parë arrinin në përafërsisht 12.59 milion DEM. Shpenzimet e themelimit të qendrës së paraburgimit dhe mbarëvajtja për gjashtë muajt e parë arrinin në 1.17 milion DEM.

⁶⁵ Shih po ashtu Frederick Lorenz, òThemelimi i sundimit të ligjit në Kosovë: Misioni i OKB,ò Gazeta REECAS, Universiteti i Uashingtonit, Pranverë 2001, shih në depts.washington.edu/reecas/newsletter/spring01/spr_news.pdf. Intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, Nëntor 2003; Intervistë me zyrtar të OSBE-së, Nëntor 2003; Strohmeyer, òIntervenimet Multilaterale,ò supra note 36, fq 119.

SHBA,⁶⁶ pasi që OKB refuzuan ti mbulojnë shpenzimet e projektuara ndërsa SHBA refuzuan ta vendosin gjykatën në bazën e saj të sigurisë së lartë. Disa nga ata të cilët kanë qenë të kyçur në proces besojnë që një pengesë shtesë, por jo primare, ka qenë shqetësimi i SHBA-ve që një gjykatë e pavarur mund ti hetojë krimet e kryera nga forcat e NATO-s, që ishte një temë kontroversë gjatë bisedimeve.⁶⁷ Si retrospektivë, juristët Shqiptar shprehin keqardhje që nuk u krijua kjo gjykatë më e pavarur, për shkak të shqetësimeve për ndikimin e PSSP-së mbi sistemin i cili u ndërtua (shih më poshtë).⁶⁸ Përfundimisht, programi i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar, pas fillimit të funksionimit në Shtator 2000, ishte ògozhda e fundit në arkivolò që shpiu në braktisjen e KWECC.⁶⁹

III. THEMELIMI I KOLEGJEVE NDËRKOMBËTARE

Në të njejtën kohë gjatë planifikimit për KWECC, autoritetet e OKB po ashtu e themeluan një program të përkohshëm për të ngritur besimin në gjyqësor, duke i marrë rastet kontroverse nga gjykatësit Shqiptar ose Sërb por pa e ndërtuar një gjykatë të re. Një valë e dhunës në Mitrovicë në Shkurt të vitit 2000, e inicuar nga hedhja e bombës në një kafe lokale dhe sulmi me raketë kundër autobusit të UNHCR i cili i transportonte Sërbët, e nxiti këtë veprim.⁷⁰ Policia e UNMIK-ut arrestoi disa Shqiptar të Kosovës të dyshuar për vringëllimë me armë, por një gjykatës Shqiptar të Kosovës i lëshoi ata. Shpërthimi i dhunës shpiu në re-evaluimin e situatës në gjyqësor nga PSSP-ja.

Pjesërisht si rezultat i kësaj ngjarje, OKB e pranuan nevojën e gjykatave dhe prokurorëve neutral për tu marrë me këto raste. Pa patur fare konsultim me popullatën vendore ó në fakt, edhe një juriste shqiptare në një pozitë të lartë në OKB tha se ajo nuk ka qenë e kyçur në procesin e vendimmarrjes⁷¹ - më 15 shkurt 2000, UNMIKU nxorri Rregulloren 2000/6. Kjo mundësoi emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar për të punuar në gjyqësinë vendore së bashku me kolegët e tyre vendor. Rregullorja i dha PSSP-së autorizim ti bëjë këto emëime, dhe deri më 17 shkurt 2000, gjykatësi dhe prokurori i parë ndërkombëtar filluan punën.⁷²

Në fillim, kjo nënkuptonte vetëm Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës dhe gjykatat tjera në juridiksionin e saj (p.sh., Gjykatat Komunale dhe të Kundërvajtjeve në Mitrovicë). Mirëpo, një numër i të paraburgosurve serb dhe të komuniteteve tjera (shumica rom) filluan grevën e urisë për të protestuar kundër paraburgimit të zgjatur.⁷³ Po ashtu, UNMIK-u kuptoi se problemi i mungesës së perceptuar të paanshmërisë te gjykatësit shqiptar të Kosovës është një problem i përgjithshëm. Si rezultat, kyçja e GJPN u zgjerua për ti mbuluar gjykatat anekënd Kosovës, duke përfshirë Gjykatën Supreme të Kosovës, nëpërmjet Rregullores 2000/34 në Maj 2000.⁷⁴ Deri në verën e vitit 2000, gjashtë GJN dhe dy PN u emëruan për të punuar në kolegje të përzier në gjykatat e Mitrovicës, Prishtinës, Gjilanit, dhe Prizrenit.⁷⁵

⁶⁶ Intervistë me zyrtar të lartë të SHB.

⁶⁷ Intervistë me zyrtar të lartë të SHB, zyrtar të OKB, dhe vëzhgues nga shoqëria civile.

⁶⁸ Disa intervista me juristë Shqiptar. Juristët Sërb kanë qenë më pak mbështetës për KWECC për shkak se nevoja për intervenim ndërkombëtar në lokacionet Serbe ka qenë e menjëshërme.

⁶⁹ Betts, supra note 36, fq.381.

⁷⁰ Intervistë me zyrtar të OSBE-së, Nëntor 2003.

⁷¹ Intervistë me një jurist Shqiptar etnik i cili më herët mbante pozitë të lartë në Departamentin e Drejtësisës së UNMIK-ut, Nëntor 2003.

⁷² Rregullorja e UNMIK-ut 2000/6, mbi Emërimin dhe Shkarkimin nga detyra të Gjykatësve dhe Prokurorëve Ndërkombëtar, 15 Shkurt 2000; shih SMSJ i OSBE-së, òGjykimet për krime Luftë në Kosovë - Shqyrtim,ò Shtator 2002, fq 11; Komunikatat për shtyp të UNMIK-ut PR/159 dhe PR/161, shih në www.unmikonline.org.

⁷³ UNMIK, òShtylla I: Policia dhe Drejtësia,ò Qershr 2004, shih në www.unmikonline.org/justice/documents/PillarI_Report_June04.pdf, fq14.

⁷⁴ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/34, e cila përmirëson Rregullorën e UNMIK-ut 2000/6, Mbi Emërimin dhe Shkarkimin nga Detyra të Gjykatësve dhe Prokurorëve Ndërkombëtar, 27 Maj 2000.

⁷⁵ Cady, supra note 36, fq 52.

Përderisa KWECC u mendua të jetë një mekanizëm i pavarur i drejtësisë tranzicionale për të përmirësuar sundimin e ligjit, kyçja e përkohshme e GJN u motivua parësisht nga nevojat pragmatike dhe të menjëhershme të sigurisë. Shpresa ishte që kyçja e ekspertëve ndërkombëtar do të shtyjë përpara procesin e reformës gjyqësore, duke dhënë kapacitetin dhe pavarësinë aq të nevojshme.⁷⁶ Pavarësisht mungesës së konsultimeve me popullatën vendore, shumica e mirëpriti emërimin e GJN për shkak se kjo mundësoi që gjykimet në Kosovë të mbahen pa rrezik të madh për anësi ose okundërpërgjigje të dhunshme.⁷⁷

Në fund të vitit 2000, autoritetet e OKB bënë përmirësime shtesë në rregulloret të cilat mundësonin emërimin e GJN dhe PN. OSBE-ja dhe OJQ-të i kritikuan rregulloret 2000/6 dhe 2000/34 sepse, përderisa ato siguronin një masë të paanshmërisë, ato nuk shkuan deri në fund. Në veçanti, ato nuk siguronin shumicën e GJN në ndonjë rast (p.sh. një gjykatës ndërkombëtar në kolegji të treve) prandaj kjo ishte òe pamjaftueshme për të përmirësuar mungesën e një dukjeje objektive të paanshmërisë në gjykimet që përfshinë pretendimet e krimeve serioze të luftës.⁷⁸ Në të vërtetë, në praktikë GJN shpeshherë kanë qenë të mbivotuar nga gjykatësit profesional dhe ata porotë kosovar, që shpiu në vendime të pavërtetuara të fajësisë kundër të akuzuarve serb dhe vendimeve të diskutueshme për lirimin e disa të akuzuarve shqiptar.⁷⁹ Po ashtu, prokurorët shqiptar të Kosovës janë akuzuar për hetimet dhe paraburgimet e serbëve të bazuara në dëshmi të pamjaftueshme, e në anën tjetër heqnin dorë nga rastet dhe refuzonin ti hetojnë shqiptarët etnik.⁸⁰ Po ashtu, për shkak të numrit të madh të rasteve, GJN ishin të stërngarkuar. Si rezultat, rastet gjykoheshin para kolegjeve me përbërje variable, disa pa GJN. Përfundimisht, shumë nga këto vendime të hershme në rastet e krimeve të luftës janë prishur me ankesë dhe kthyer në rigjykim.⁸¹

Duke ju përgjigjur këtyre shqetësimeve, OKB në dhjetor të vitit 2000 nxorri Rregullorën 2000/64.⁸² Kjo i jep PSSP-së autoritet që të emërojë kolegji të posaçëm nga tre gjykatës me shumicë ndërkombëtare, të ashtuquajturin òKolegji i Rreg.64ò, si dhe autoritet që të emërojë PN.⁸³ Si rrjedhojë, një seksion special, Seksioni Ndërkombëtar për Mbështetje Gjyqësorit (IJSS), u themelua në kuadër të DD⁸⁴ për ta mbështetur këtë iniciativë. Edhe pse IJSS në fillim mbështeste edhe GJN edhe PN, më pas PN janë ndihmuar nga Divizioni Penal. Me lindjen e òkolegjeve të Rreg.64,ò të cilat janë ekskluzivisht ndërkombëtare, formacioni i përzier i Rregullorës 6 u braktis.

A. Mekanizmat shkrehës për kolegjet e Rregullorës 64

⁷⁶ Raporti i OSBE-së Shtator 2002, supra note 72, fq 11.

⁷⁷ Intervistë me përfaqësues ndërkombëtar nga QRMP, Nëntor 2003; shih po ashtu intervista me jurist vendor Shqiptar, Nëntor 2003.

⁷⁸ Raporti i OSBE-së Shtator 2002, supra note 72, fq11. Në bazë të ligjit të aplikueshëm në Kosovë në atë kohë, krimet e rënda duhej të gjykoheshin nga dy gjykatës professional dhe tre porotë; prandaj, edhe caktimi id y GJN nuk do ta siguronte shumicën e ndërkombëtarëve.

⁷⁹ Hartmann, supra note 29, fq 10.

⁸⁰ Id.

⁸¹ Raporti i OSBE-së Shtator 2002, supra note 72, fq 11.

⁸² Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64, mbi Emërimin e Gjykatësve/Prokurorëve ndërkombëtar dhe/ose Ndërrimin e Vendit, 15 Dhjetor 2000. Rregullorja hyri në fuqi në fillim për një periudhë 12 muajshe, por është zgjatuar me Rregullorën 2001/34 dhe 2002/20. Për diskutim shtesë në lidhje me Rregullorën e UNMIK-ut 2000/64 shih raportin e SMSJ të OSBE-së, òShyrtimi i Sistemit të Drejtësisë Penale,ò supra note 48, fq 75.

⁸³ Vlen të theksohet se rregullorja e UNMIK-ut 2000/6 i jep GJN dhe PN të drejtën të zgjedhin rastet dhe marrin përgjegjësinë për ato rate të cilat i vlerësojnë të përshtatshme për gjyqësinë ndërkombëtare. Dallimi është se kur PSSP-ja e cakton Kolegjin 64, i tërë kolegji mund të jetë ndërkombëtar, përderisa në praktikë, kolegji i Rregullorës 6 është një ose dy GJN nga tre. Sa i përket PN, Rreg.64 gati se nuk përdoret, pasi që PN zakonisht i marrin rastet në bazë të Rregullorës 2000/6.

⁸⁴ DD për momentin përbëhet nga pesë seksione: Divizioni i Zhvillimit Gjyqësor (JDD), Divizioni për Mbështetjen Gjyqësorit Ndërkombëtar (IJSD), Divizioni Penal (DP), Divizioni i Menaxhimit Penal (PMD), dhe Zyra për Personat e Zhdukur dhe Mjekësinë Ligjore (OMPF).

Rregullorja 2000/64 vazhdon të jetë e aplikueshme në Kosovë edhe sot. Mekanizmat shkrehës për të ashtuquajturin òKolegj të Rreg.64ò përfshinë emërimin nga ana e PSSP-së në bazë të vendimit të tij, osë në bazë të kërkesës së prokurorit, të akuzuarit, ose avokatit mbrojtës kur òshtë e nevojshme për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit osë administrimin e duhur të drejtësisë.ò⁸⁵ Edhe pse nuk ka kritere të qarta në Rregullore, në praktikë arsyet primare për mbështetjen në GJN janë osë frika për perceptcionin e anshmërisë osë shqetësimet lidhur me sigurinë e gjykatësve vendor. ⁸⁶ Si rezultat, GJPN janë përdorur më së shumti në rastet që kishin të bëjnë me konflikt ndëretnik.⁸⁷ Në këto raste, DD i bën rekomandim PSSP-së, i cili e merr vendimin formal për të emëruar prokurorin ose kolegjin me shumicë ndërkombëtar në ndonjë rast specifik. Palët të cilat kërkojnë kolegj të Rreg.64 e bëjnë kërkesën e tyre DD, i cili ia përcjell PSSP-së. Prokurorët ndërkombëtar dhe gjykatësit mund poashtu ti marrin rastet në bazë të diskrecionit të tyre.⁸⁸ (Trazirat e marsit 2004 filluan një periudhë të re në të cilën gjykatësit vendor po ashtu gjykuan rastet që kishin të bëjnë me konflikt ndëretnik.⁸⁹)

Emërimi i kolegjtit të Rreg. 64 mund të ngjajë në çdo fazë të procedurës, përveç se kur shqyrtimi kryesor osë procedura e ankesës ka filluar. Òshtë menduar që kjo do të ndikonte në procedurë, dhe që ndonjë paragjykim i cili del në këtë fazë mund të eliminohet me emërimin e trupit gjykues ndërkombëtar për të ndëgjuar ankesën osë mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër ankesës. Megjithatë, kjo është një pushtet i madh që ka sjellur te pakënaqësitë nga profesionistët vendor të cilët janë larguar nga rasti, nganjëherë në mënyrë tepër demonstrative.

GJN gjykojnë rastet në gjykatat e rregullta në Kosovë dhe PN punojnë si prokuror vendor, të gjithë duke e aplikuar ligjin e njejtë vendor si edhe kolegët e tyre vendor.⁹⁰ Mirëpo, GJN nuk i marrin rastet nga kryetarët e gjykatave ku shërbejnë. Më saktë, ata i pranojnë rastet nga DD osë mund të kërkojnë vetë ta marrin rastin në bazë të Rregullores 2000/6 osë 2000/64. Në praktikë, GJPN *de facto* funksionojnë si proces gjyqësor paralel për rastet ku DD osë GJPN i konsiderojnë të papërshtatshëm për kolegët vendor.

B. Programi i Gjykatësve Ndërkombëtar

Deri më 15 dhjetor 2000, në Kosovë u emëruan 10 GJN.⁹¹ Gjatë vitit 2001, numri i GJN u luhet, por erdhi deri më 17 sish.⁹² Për momentin, janë 17 vendë për GJN, edhe pse nga shtatori i vitit 2005, vetem 14 vende janë plotësuar, dhe në Nëntor ishin vetëm 11 osë 12.⁹³ Në fillim të vitit 2005 u krijua posti i Kryegjykatësit Ndërkombëtar, i cili ka përgjegjësi gjyqësore dhe administrative. Ky post u krijua me qëllim që drejtori i DD të shkarkohet nga detyrat të cilat ndikojnë në paraqitjen e pavarësisë së gjyqësorit.

⁸⁵ Id.

⁸⁶ Intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, Nëntor 2003.

⁸⁷ Intervistë me gjykatës vendor, Nëntor 2003.

⁸⁸ Almut Schroder, òForcimi i Sundimit të Ligjit në Kosovë dhe Bosne e hercegovinë: Kontributi i Gjykatësve dhe Prokurorëve Ndërkombëtar,ò Qendra Ndërkombëtare për operacionet e Paqës, Berlin, Gjermani, Prill 2005.

⁸⁹ Shih mënyrën e trajtimit të rasteve të trazirave të Marsit nga SMSJ i OSBE-së, òShqyrtimi i sistemit të drejtësisë penale,ò supra note 2.

⁹⁰ Cady, supra note 36, fq 53 (citim i gazetës Zyrtare të Kosovës nr.21/78)

⁹¹ Hartmann, supra note 29, fq 12.

⁹² Id.

⁹³ Për momentin ekziston Kryegjykatësi Ndërkombëtar; GJN shërbejnë në Gjykatën Supreme të Kosovës; dhe një numër i GJN shërbenin në nivelin e Gjykatave të Qarkut si dhe në ate komunale. Si krahasim, pas emërimit më 4 Dhjetor 2003 të 26 gjykatësve të ri vendor, pjesa tjetër e gjyqësisë vendore ka 316 gjykatës, 90 përqind nga të cilët janë Shqiptar, 5 përqind Serb, dhe 5 përqind nga grupet tjera etnike. Shih S/2004/262, òLetra me datë 30 Mars 2004 e adresuar Kryetarit të Këshillit të Sigurimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Nuk ishte e lehtë të plotësohen vendet ekzistuese.⁹⁴ autoritetet e UNMIK-ut i shpallin vendet e punës nëpërmjet OKB, dhe aplikacionet dërgohen në zyren e personelit të UNMIK-ut. Kryegjykatësi Ndërkombëtar i shqyrton aplikacionet dhe e bën një listë të shkurtë për intervistë. Të gjithë kandidatët intervistohen nëpërmjet telefonit, zakonisht nga dy GJN ekzistues, udhëheqësi i IJSD, dhe përfaqësuesi i zyrës së personelit të UNMIK-ut. Ky sistem është kritikuar si i rastit dhe për vështirësitë për arritjen e kontrollit të kualitetit nëpërmjet asaj distance. Shumica e aplikacioneve vijnë nga Afrika, Azia, ose Europa Lindore, sepse u tregua që është e vështirë për gjykatësit nga Amerika Veriore apo Europa Perendimore të marrin pushim nga detyrat e tyre të rregullta gjyqësore për të shërbyer në Kosovë. Janë bërë disa marrëveshje të posaçme bilaterale, si p.sh. me shtetin e Minesotas, që rezultoi në një numër të gjykatësve nga atje të vinin në shërbim në Kosovë. Gjykatësit nuk nominohen formalisht nga shtetet anëtare, e as nuk janë personel i deleguar në UNMIK ó DD nga shtetet anëtare ose institucionet tjera. Të gjithë GJPN janë zyrtarisht të zgjedhur, merren në punë, dhe paguhën nga UNMIK-u.

Vështirësitë në rekrutimin e personelit kualitativ burojnë nga disa faktorë. Nga gjykatësit ndërkombëtarë të cilët janë emëruar në mes të vitit 1999 deri më 2001, pak nga ata kishin gjykuar rastet që përfshinin vepra të rënda penale dhe asnjëri nuk kishte asnjë përvojë praktike në, ose dijeni të drejtës ndërkombëtare humanitare para emërimit të tyre.⁹⁵ Për shembull, njeri nga gjykatësit ndërkombëtar kishte përvojë ekskluzivisht në të drejtën bregdetare. Po ashtu, shumica nga gjykatësit nuk ishin të njohur me sistemin juridik në Kosovë i cili është një përzierje unike në mes të drejtës kontinentale dhe asaj anglosaksone.⁹⁶ Për më tepër, marrëveshjet ad hoc për rekrutimin dhe emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar, të cilët emërohen me kontrata gjashtë mujore, e bën të vështirë të gjendet personel i kualifikuar të cilët janë të gatshëm atëherë kur është nevojë. OKB nuk e mbajnë ndonjë listë të kandidatëve potencial për pozita gjyqësore në gjykatat ndërkombëtare ose hibride, dhe disa konsiderojnë se një listë e tillë do të ndihmonte, ose se ndonjë ekip i përhershëm i i gjykatësve duhej të formohej.⁹⁷ Përveç kësaj, shqetësimet për sigurinë personale ose faktorë tjerë praktik mund të citohen si dëbuese për kandidatët e mirë. Për shembull, shumë ndërkombëtarë do të duhet të mësohen në mbrojtjen e afërt dhe pengesat tjera të sigurisë.

Gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar pagohen në bazë të shkallës së OKB për profesionistë e cila i përgjigjet përvojës së tyre. Pagat e tyre sigurohen nga OKB e jo nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. GJPN më së shpeshti punësohen në nivelin P3, P4, ose P5. Në fillim, shumë janë punësuar dhe avancuar në nivelin D1, por zyra ka hequr dorë nga kjo praktikë. Së voni, pozita e Kryegjykatësit u kategorizua si niveli D1. Si është e zakonshme me tribunatet hibride, pagat e GJPN shumëfish i tejkalojnë ato të kolegëve të tyre vendor.⁹⁸ Përderisa një pozitë P5 në sistemin e OKB paguhet 100.000\$ ne vjet plus një mëditje ditore prej 350 \$, një gjykatës i Gjykatës së Qarkut në Kosovë paguhet mesatarisht nga 350 Euro, ndërsa Kryetari i Gjykatës Supreme paguhet 550 Euro në muaj. Po ashtu, gjykatësit vendor nuk pranojnë beneficione të shumta. Një gjykatës ishte i sëmurë për tetë muaj por morri vetëm dy javë pushim mjekësor të paguar. Një gjykatës tjetër i Gjykatës Supreme tha se pensioni i tij do të jetë vetëm 40 Euro në muaj.

⁹⁴ Intervista me zyrtar të UNMIK-ut, Nëntor 2003.

⁹⁵ Marshall, supra note 29, fq 129.

⁹⁶ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/2, 12 Janar 2001, në seksionin 2, i parashtron kriteret për gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar si vijon: Gjykatësit dhe Prokurorët ndërkombëtar duhet: (a) të kenë diplomë të fakultetit juridik; (b) të kenë qenë të emëruar dhe punuar, së paku 5 vite, si gjykatës ose prokuror në shtetin e tyre; (c) të kenë integritet të lartë moral; dhe (d) të mos ketë qenë të dënuar për vepra penale.

⁹⁷ Shih, p.sh. Cesare Romano, "Gjykatësit dhe Prokurorët e Gjykatave Penalë dhe Tribunalëve të ndërkombëtarizuar," në Romano e al. supra note 61, fq 252 ó 259.

⁹⁸ Indexi i Reformës së Gjyqësorit në Kosovë (ABA/CEELI), Vol. I, Prill 2002, fq 27.

Mungesa e trajnimit të duhur për GJPN është e dukshme. Përveç një kursi njoftues me informata themelore mbi jetën në Kosovë, gjykatësit ndërkombëtar nuk kanë trajnime mbi sistemin ligjor në Kosovë para se ta fillojnë punën. Nuk ka ndonjë trajnim paraprak mbi të drejtën humanitare, procedurën penale, ose kodin penal të Republikës Federale të Jugosllavisë.⁹⁹ Në shtator 2000, TPNJ e mbajti një sesion trajnimi mbi të drejtën humanitare për gjykatësit dhe prokurorët, por kjo nuk u mbajt në baza të rregullta. Një pjesë e vështirësive buron nga fakti se mesatarja e qëndrimit në post është shumë e shkurtë. Në mënyrë tipike, GJN disa muaj njoftohen me sistemin, dhe atëherë ata mund ti gjykojnë vetëm një apo dy raste komplekse para kthimit. Për shkak të kontratave të shkurta, ka ndodhur që GJN ta kryejë misionin para përfundimit të rastit, që rezultoi në vonesa për shkak të nevojës të rifillohet gjykimi.¹⁰⁰

UNMIK-u në përgjithësi ka vuajtur nga mungesa e përkthyesve për ti përkthyer tekstet ligjore. Kjo ka shkaktuar vonesa në gjykim. Zakonisht gjykatësit ndërkombëtar dhe ata vendor mund të diskutojnë në mes veti vetëm nëpërmjet përkthyesve. Shumë GJPN dhe juristë vendor ndiejnë që kualiteti i përkthimit vazhdon të jetë problem i madh, pasi që shumë nga përkthyesit the interpretet nuk janë të specializuar në çështjet ligjore. GJN shpesh marrin vendime pa e kuptuar në mënyrë ekzakte se çka është thënë në vendimin e gjykatës më të ulët.¹⁰¹

Gjykatësit vendor në përgjithësi pajtohen se ka arsye të rëndësishme për GJN të merren me rastet e ndjeshme.¹⁰² Mirëpo, disa janë ankuar se nuk janë të kyçur sa duhet në vendimarrje për shpërndarjen e rasteve në përgjithësi.¹⁰³ Për më tepër, për shkak se rregullorja 2000/64 i jep diskrecion të gjërë për emërimin e GJN në një mori rrethanash, emërimi i GJN ndonjëherë dukej arbitrar dhe ad hoc.¹⁰⁴ Ky aspekt i procesit ka qenë subjekt i kritikave të pareshtura nga OSBE-ja dhe të tjerët, por nuk ka patur ndryshime.¹⁰⁵ Në disa raste, ndërkombëtarët janë caktuar në raste të cilat nuk kanë qenë të rënda dhe nuk kërkonin përfshirjen e tyre, si p.sh. aksidentet e trafikut ku ishin përfshirë zyrtarët e UNMIK-ut ose vjedhjet e pyllit. Asnjë direktivë nuk e udhëheq në mënyrë eksplicite këtë proces të vendim marrjes, dhe caktimi i GJPN nuk ka qenë çdoherë strategjik.

Gjykatësit dhe avokatët vendor japin vlerësime të përziera për GJN. Përderisa shumë nga ata thonë se GJN janë kompetent,¹⁰⁶ disa gjoja nuk janë. Gjykatësit vendor cekin se disa nga GJN nuk kanë shërbyer si gjykatës më herët.¹⁰⁷ Keqkuptimet dhe fërkimet mund të ndodhin në mes të juristëve vendor dhe ndërkombëtar dhe ato mund të keqësohen për shkak të mungesës së komunikimit e cila vjen si pasojë e mosekzistimit të gjuhës së përbashkët punuese në gjykata.¹⁰⁸ Juristët ndërkombëtar nuk e flasin gjuhën vendore, përderisa shumica e juristëve vendor nuk e flasin gjuhën angleze. Juristët vendor i kanë kritikuar GJN për mosnjohje të duhur të ligjeve vendore, ne veçanti rregullat e dënimit dhe përdorimin e

⁹⁹ Marshall, supra note 29, fq 129.

¹⁰⁰ Kjo ndodhi në rastin Sali Veseli et al., po ashtu i njohur si rasti i òKomandant Drinitò në Prizren. Kur GJN u largua para se të përfundonte rasti u desht që gjykimi të rifillojë.

¹⁰¹ Në shumicën e rasteve juristëve i jepet një përmbledhje e shkresave në gjuhën angleze dhe sipas kërkesës, përkthime të dokumentave të ndryshëm.

¹⁰² Intervista me gjykatës vendor, Nëntor 2003.

¹⁰³ Id.

¹⁰⁴ Id., intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, nëntor 2003.

¹⁰⁵ SMSJ i OSBE-së, Shqyrtim i sistemit të drejtësisë penale, supra note 48, fq 29-30.

¹⁰⁶ Shih, p.sh., intervistë me avokat mbrojtës shqiptar, nëntor 2003, intervistë me gjykatës vendor shqiptar, nëntor 2003.

¹⁰⁷ Intervista me avokat vendor shqiptar, nëntor 2003.

¹⁰⁸ Schroder, supra note 88, fq 21.

precedentëve,¹⁰⁹ një shqetësim i cili poashtu ka qenë i vërejtur nga monitorët ndërkombëtar. Disa poashtu janë ankuar se ndërkombëtarët kanë tendencë të zgjatjes së gjykimeve.

Përderisa gjykatësit vendor dhe avokatët tregojnë se marrëdhëniet me GJN janë përgjithësisht kolegjiale, shumica do të dëshironte më tepër bashkëveprim joformal dhe sa i përket përmbajtjes së rastit.¹¹⁰ Në fakt, me disa përjashtime ó si janë Gjykata e Qarkut në Mitrovicë dhe Gjykata Supreme ó zyret e GJN dhe PN janë zakonisht në ndërtesa të ndara nga gjykatësit vendor. Në disa lokacione, si është Peja, ka patur takime të rregullta në mes të gjykatësve vendor dhe ndërkombëtar, por kjo është e rrallë.¹¹¹ Në disa gjykime, GJN janë konsultuar me kolegët vendor vetëm për disa minuta para gjykimit.¹¹² Gjykatësit vendor dhe avokatët po ashtu i kanë cilësuar disa nga GJN si arrogant,¹¹³ dhe theksojnë se disa nga ata nuk kanë dëshirë të mësojnë nga gjykatësit vendor.¹¹⁴ Ata poashtu cekin se disa nga GJN nuk e vlerësojnë fuqinë e juristëve vendor.¹¹⁵ Veç kësaj, derisa disa nga gjykatësit vendor thonë se kanë mësuar dhe përfituar nga bashkëveprimi dhe shkëmbimi me GJN,¹¹⁶ GJN në përgjithësi nuk e kanë marrë rolin e mentorit. GJN thonë se nuk kanë kohë të mjaftueshme për mentorim, dhe cekin se kjo nuk është pjesë e përshkrimit të tyre të punës. Shkalla e bashkëveprimit prandaj varet nga personaliteti.¹¹⁷ Tani që të gjithë gjykatësit janë zhvendosur në Prishtinë, këto raste mund të bëhen edhe më të rralla pasi që ata nuk kanë më bashkëveprim me kolegët anekënd krahinës.

Thënë shkurt, prezenca e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar mund të ketë ndihmuar në minimalizimin e paraqitjes së anëshmërisë në gjyqësi,¹¹⁸ por kjo detyrë nuk ka qenë e lehtë në Kosovën etnikisht të ndarë.¹¹⁹

C. Prokurorët Ndërkombëtarë

Deri më 15 dhjetor 2000, kanë qenë të emëruar tre PN në Kosovë. Në gusht 2001, PN i parë u emërua në Prokurorinë Publike të Kosovës, duke e sjellur numrin e PN në gjashtë. Gjatë vitit 2001, numri i PN u rrit në 11.¹²⁰ Në fund të vitit 2005, në Kosovë kishin mbetur nëntë PN. Procesi i rekrutimit dhe zgjedhjes është i ngjajshëm me ate të GJN, dhe shkalla e ndërrimeve është poashtu e lartë.¹²¹ Vështirësitë në rekrutimin e stafit kualitativ janë të ngjashme me ate të GJN, edhe pse si mestare kualiteti është pak më i lartë. Bashkëveprimi në mes të PN dhe prokurorëve vendor (PV) është zakonisht sipërfaqësor. Kjo ndodh

¹⁰⁹ Intervistë me avokat Shqiptar, Nëntor 2003 (përshruan rastin në të cilin gjykatësi gabimisht mendoi se maksimumi i dënimit është 20 vite burgim por ishte më pak se 15 sipas ligjit të aplikueshëm Jugosllav); intervistë me gjykatës Shqiptar, Nëntor 2003.

¹¹⁰ Intervistë me gjykatës vendor Shqiptar, Nëntor 2003 (përshkruan marrëdhëniet me GNJ si të òmiraò dhe òkolegjialeò); intervistë me gjykatës Shqiptar, Nëntor 2003.

¹¹¹ Intervistë me GJN, Neë York, Tetor 2004.

¹¹² Intervistë me gjykatës dhe avokat Shqiptar, Nëntor 2003.

¹¹³ Id., intervistë me zyrtar të OSBE-së, Nëntor 2003.

¹¹⁴ Id.

¹¹⁵ Intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, Nëntor 2003.

¹¹⁶ Intervistë me gjykatës Shqiptar, Nëntor 2003 (lavdëron òshkëmbimin e përvojës dhe stilin profesional të kolegejeve të përziëra, për shkak se praktika e shteteve të ndryshme jep kontraste ilustrativeò dhe duke cekur se òkjo i jep një ton më demokratik gjykatave tona të cilat kanë qenë autokratikeò).

¹¹⁷ Intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, Nëntor 2003.

¹¹⁸ Shih p.sh., òGjykimet për krime të Luftës në Kosovë,ò supra note 72, fq 10; Cerone supra note 61.

¹¹⁹ Për diskutim mbi armiqësitë etnike në Kosovë, shih p.sh., Grupi Ndërkombëtar i Krizave, òKolapsi në Kosovëò, supra note 33, dhe òkosova: drejt Statusit Përfundimtar, Raporti European nr.161,ò 24 janar 2005. Raporti i dytë vëren, òpër Kosovarët, fajësia Serbe për krimet e luftës mbetet kolektive, jo individuale,ò dhe shënon se perëndimi i Kosovës është një zonë më e vështirë se sa pjesa lindore, e cila nuk pati shumë luftime (7-8).

¹²⁰ Hartmann, supra note 29, fq 12.

¹²¹ Id.

sepse PN kanë tendencë të punojnë vetëm dhe rastet nuk ndahen në mes të prokurorëve vendor dhe ndërkombëtar, dhe po ashtu sepse nga PN nuk kërkohet që të marrin një rol të mentorit.¹²² Disa ndiejnë se ekipet e përbashkëta të prokurorëve vendor dhe ndërkombëtar do të ishin ide e mirë,¹²³ por kufizimet kohore dhe shqetësimet për sigurinë e e kanë ndaluar këte.¹²⁴ Veç kësaj, shumë nga rastet janë të thjeshta dhe nuk kërkojnë që me to të merret ekipi me disa anëtarë. Ndonjëherë, rasti do ti jepet prokurorit vendor me PN si monitor por kjo është e rrallë.¹²⁵ Poashtu problematik ka qenë fakti se për një kohë të gjatë UNMIK-u nuk ka patur asnjë vendor të punësuar në Divizionin Penal.¹²⁶ Faktor shtesë është trashëgimia e komunizmit, e cila si duket i bënë vendorët të jenë tepër të respektueshëm. Pakënaqësitë mund po ashtu të shfaqen kur PN i marrin rastet nga prokurorët vendor.¹²⁷

IV. STRATEGJIA PROKURORIALE DHE ÇËSHTJET E ZGJEDHJES SË RASTEVE

A. Mungesa e kritereve për kalim të rasteve

Çka i dallon kolegjet e Rreg.64 nga sistemet tjera që përfshinë gjykatës dhe prokuror ndërkombëtar është diskrecioni i tyre i gjërë për të marrë ndonjë rast vendor i cili është në proces. Mungesa e drejtimit të qartë se ku duhet të përqëndrohen ndërkombëtarët mbetet çështje kundërthënëse dhe kritike. Si u përmend më herët, PSSP-ja mund të aprovojë kolegjin e Rreg. 64 për çdo rast ó nga krimet e luftës e deri te vjedhjet ó nëse konsiderohet òe nevojshme për të siguruar pavarësinë dhe paanësinë e gjyqësorit ose administrimin e duhur të drejtësisë.¹²⁸ Duke e përdorur këtë shpjegim, GJPN në fillim u përqëndruan në aktakuzat për krime të luftës të ngritura kundër serbëve, pjesërisht për shkak se një numër i tyre ishte në paraburgim kur erdhën ndërkombëtarët. Ata i trashëguan 43 raste të tilla të cilat kishin filluar para trupave gjyqës vendor.¹²⁹ GJPN po ashtu morrën rastet kundër shqiptarëve të Kosovës, veçanërisht *Rastin Llapi*, i cili përfshinte ish liderë të lartë të UÇK-së.¹³⁰

Mirëpo, gradualisht fokusi u zhvendos nga rastet e konsideruara si të papërshtatshme për gjykatësit dhe prokurorët vendor në rastet të cilët gjykatësit dhe prokurorët vendor nuk dëshironin ti gjykonin për shkak të shqetësimeve për sigurinë apo presioneve politike. Përqëndrimi parësor i GJPN tani janë rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit.¹³¹ Si tha një PN, këto kategori të rasteve shpeshherë janë të ndërlidhura, për shkak se strukturat kriminale, duke përfshirë krimin e organizuar, janë po ashtu të përfshira në terrorizëm dhe dhunë ndëretnike.¹³² Në anën tjetër, krimi i organizuar është karakteristikë e rregullt jo vetëm në kontekstin e situatës së post-konfliktit, por po ashtu e shteteve të Europës Lindore. Disa

¹²² Shih, p.sh. intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, Nëntor 2003; intervistë me PN, Nëntor 2003; intervistë me zyrtar të OSBE-së, Nëntor 2003; intervistë me avokat Shqiptar, Nëntor 2003.

¹²³ Intervistë me avokat Serb, Nëntor 2003; intervistë me PN, nëntor 2003 (cek se ka një mungesë të diskursit ktëo në mes të komunitetit ligjor ndërkombëtar dhe atij vendor); intervistë me përfaqësues ndërkombëtar të OJQ, nëntor 2003.

¹²⁴ Intervistë me PN, Nëntor 2003.

¹²⁵ Intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, Nëntor 2003.

¹²⁶ Vlen të përmendet se gjatë vitit të kaluar 50 janë punësuar në pjesët tjera të DD.

¹²⁷ Gregory L. Naarden dhe Jeffrey B. Locke, òShënim dhe Koment: Politikat paqëruajtëse dhe prokuroriale: Mësimet nga Kosova, ò American J. Int'l Law, Tetor 2004, fq 729. Kompetencat e prokurorëve publik parashihen në Ligjin mbi Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare 32/76, 1988 (Kosovë).

¹²⁸ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64 neni 1.2, mbi ò

¹²⁹ Intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, nëntor 2003.

¹³⁰ Intervistë me dy zyrtarë të UNMIK-ut, nëntor 2003.

¹³¹ Intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, nëntor 2003; shih po ashtu intervistë me gjykatës shqiptar, Nëntor 2003, i cili tha se derisa është ndihmesë që GJPN merren me rastet e krimit të organizuar, më shume krime të luftës duhet të ndiqen; intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, nëntor 2003.

¹³² Hartmann, supra note 29, fq 12.

ankohen se zhvendosja e përqëndrimit paraqet prioritetin e Europës dhe Amerikës, e jo ate vendor.¹³³ (GJPN po ashtu janë marrë me një numër të rasteve që përfshinë personelin e OKB).¹³⁴

B. Shqetësimet lidhur me pavarësinë

Kritikë kryesore ndaj sistemit të GJPN ka qenë se kjo strukturë i jep PSSP-së pushtetin final ekzekutiv për të emëruar gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar dhe ti zgjedhë rastet në të cilat ata do të jenë të kyçur. Për më tepër, DD i UNMIK-ut është autoritet mbikëqyrës mbi gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar, i cili i zgjat kontratat e tyre. Gjykatësit ndërkombëtar nuk i nënshtrohen Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë (KGJPK), trup i cili i emëron dhe disiplinon gjykatësit vendor, dhe nuk ka përfshirje vendore në mbikëqyrjen e GJPN. Në *Shqyrtimin e Sistemit të Drejtësisë Penale*, SMSJ i OSBE-së tha, ÷periudha e shkurtë kontraktuese për gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar, dhe fakti se cdo zgjatje e këtyre kontratave varet ekskluzivisht nga degët ekzekutive të UNMIK-ut ó DD dhe, përfundimisht PSSP-ja - krijojnë një paraqitje të kontrollit të ekzekutivit mbi këta zyrtarë.¹³⁵ SMSJ rekomandoi që, për tu siguruar pavarësia, vendimet mbi punësimin dhe zgjatjen e kontratave të GJPN, duhet të jenë nën kompetencën e një KGJPK të fuqizuar. Ky rekomandim nuk u implementua asnjëherë, dhe gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar shihen si subjekt që i nënshtrohet fuqisë mbikëqyrëse nga OKB.¹³⁶ Kjo paraqitje e mungesës së pavarësisë ka shpjer në dyshimet e shfaqura nga disa mbi paanësinë e procesit hibrid.

Në mes të rasteve të krimeve të luftës dhe atyre ndëretnike që përbëjnë shumicën e rasteve me të cilët janë ngarkuar GJPN, kundërthënia parësore ka qenë se a ka qenë politikisht e anshme zgjedhja e rasteve nga PSSP-ja dhe DD. Shumë nga vëshguesit, përfshirë këtu kosovar dhe ndërkombëtar,¹³⁷ besojnë se UNMIK-u ushtron influencë të tepruar mbi procesin e drejtësisë penale. Pa marrë parasysh se a është kjo e arsyeshme, ka një perceptim lokal se ndërhyrjet politike jo proporcionalisht i kanë mbrojtur të akuzuarit serb, dhe disa pohojnë se UNMIK-u ka një mënyrë të ÷dorëzimitó para kërkesave serbe. Disa pohojnë se shumë raste të sjellura në fillim kundër serbëve para kolegjeve vendore rezultuan në zvogëlim dramatik të akuzave, dënimeve dhe lirimeve kur GJPN i morrën rastet.¹³⁸

Për më tepër, disa shqiptar të Kosovës e perceptojnë një anësi sistematike në dy fronte.¹³⁹ Së pari, Serbia është shtet, përderisa Kosova nuk është, dhe shqiptarët frikohen se zyrtarët e OKB ndien më të rehatshëm në diplomaci me Serbinë. Së dyti, disa shqiptarë besojnë se averzioni i UNMIK-ut ndaj kërcënimeve mbi stabilitetin i ka dhënë serbëve radikal një veto efektive kundër politikave të OKB, përfshirë këtu edhe ndjekjet penale.¹⁴⁰

¹³³ Intervistë me zyrtar të Departamentit të Shtetit dhe ish zyrtar të UNMIK-ut.

¹³⁴ Intervistë me avokat mbrojtës serb, nëntor 2003, i cili e mbrojti një rast të tillë.

¹³⁵ SMSJ i OSBE-së, ÷Shqyrtimi i Sistemit të Drejtësisëó supra note 48, fq 26.

¹³⁶ Cerone, supra note 61.

¹³⁷ Intervistë me gjykatës shqiptar, Nëntor 2003; intervistë me avokat shqiptar, nëntor 2003; intervistë me dy avokat shqiptar, nëntor 2003; intervistë me redactor të gazetës shqiptar, Nëntor 2003; intervistë me përfaqësues të OJQ, nëntor 2003.

¹³⁸ Shih Raportin e OSBE-së, supra note 72, fq 12 ó 28 (përmbledhjet e rasteve); shih po ashtu intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, nëntor 2003.

¹³⁹ Numër më i vogël i shqiptarëve e akuzoi drejtëpërdrejtë UNMIK-un më anësi etnike, duke cituar mos respektin që ndërkombëtarët tregojnë ndaj tyre.

¹⁴⁰ Shembujt që përmenden më së shpeshti janë arratisjet e një numri të madh të paraburgosurve serb nën rrethana të çuditshme, numri i vogël i rasteve të suksesshme të krimeve të luftës kundër serbëve, dështimi për ndjekje penale kundër ÷Rojave të Urësó (së paku deri sa nuk i lënduan ndërkombëtarët), dhe paaftësia os mos dashja për të kërkuar ekstradimin e të dyshuarve kryesor serb të cilët fshihen ën Serbi. Këto shembuj, së bashku me perceptimin e dënimeve jo të barabarta (shih më poshtë) raportohen vazhdimisht në mediat lokale. Intervistë me redactor gazete shqiptar, nëntor 2003.

Zyrtarët e DD kanë pohuar se zgjedhja e rasteve nuk është politike. Si tha njëri, òNe nuk do të merrnim në konsideratë asnjëherë balancin etnik gjatë vendosjes se cilat rastë duhet të ndiqen ose si jepen vendimet. Pyetja e vetme që ekziston është se a mundet rasti të ndiqet penalisht. PSSP-ja nuk bën ndikime.ò¹⁴¹ DD i identifikon faktorët kufizues të ndjekjeve penale jo si politik, por si mungesë të mbështetjes për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe mundësitë e zbehta të ekstradimit.¹⁴²

C. Mungesa e bashkëpunimit nga Serbia

Shumë nga ata të cilët kanë kryer krime në vitin 1999, përfshirë serbët dhe serbët nga Kosova, me përfundim të konfliktit u tërhoqën në Sërbi. Shumë nga ata mbesin të pakapshëm në Serbi dhe Mal të Zi si dhe në shtetet tjera Europiane. Si tha një PN, òNe nuk patëm mundësi ti dënojmë disa persona kyç ó ata të cilët ikën, ata të cilët i akuzuam dhe nuk mundëm ti arrestonim, dhe ata të cilët nuk i akuzuam. Kjo është me rëndësi për popullatën e këtushme, posaçërisht për shkak se kemi shumë pak ndjekje penale të suksesshme ndaj serbëve të cilat mund ti cekim.ò¹⁴³ Për më tepër, perceptimi është se më tepër është bërë të sillen para gjykatës shqiptarët se sa serbët.

Ekstradimi ka qenë i vështirë për tu negociuar, pjesërisht sepse Kosova është protektorat i OKB dhe jo shtet i pavarur.¹⁴⁴ UNMIK-u, në pajtim me statusin e tij *sui generis*, negocion dhe hyn në marrëveshjet bilaterale me shtetet për transfer të dyanshëm (ekstradim) të shtetasve të huaj dhe banorëve të Kosovës. Këto negociata komplikohen nga politika e brendshme e Serbisë, duke përfshirë sukseset e vonshme të kandidatëve më nacionalist dhe problemi i vazhdueshëm i shqiptarëve të Kosovës të zhdukur për të cilët besohet se janë në Serbi. Me sa duket disa nga këto çështje do të jenë pjesë e përcaktimit të statusit përfundimtar të Kosovës.

D. Përmirësimet Strukturale të Sistemit të GJPN

Ka patur përpjekje që të vendoset një strukturë më e centralizuar në programin e GJPN në mënyrë që të mundësohet një shpërndarje më strategjike. Në mars 2003, u themelua Divizioni Penal. U emëruan Kryegjykatësi dhe Kryeprokurori ndërkombëtar, të cilët ishin përgjegjës ndaj DD.¹⁴⁵ Kreu i Divizionit Penal i monitoron zhvillimet në të gjitha rastet, e cakton rëndësinë e çdo rasti, dhe me PN i sajton masat që duhet të merren. Divizioni Penal, që ka qenë i përbërë ekskluzivisht nga PN dhe juristët ndërkombëtar që i mbështetnin prokurorët, punuan paralel me shërbimet vendore prokuroriale.¹⁴⁶

Hapa të mëtejshëm janë marr në 2005 për të themeluar Zyrën e Prokurorisë Speciale të Kosovës (ZPSK). Që nga shtatori 2005, janë siguruar fondet nga Agjensioni Europian për Rindërtim, janë përpiluar shpalljet për punë, dhe një draft rregullore me të cilën themelohej ZPSK u përpilua nga zyra ligjore e UNMIK-ut (ZL) dhe DD në fund të vitit 2005. ZPSK do të jetë në strukturën e Zyrës së Prokurorit Publik. Propozimi është që mandati i ZPSK do të përfshin rastet e rënda të cilat për momentin i mbulon Divizioni Penal. Do të fillojë me dy ose tre prokuror vendor dhe do të zgjerohet derisa të jetë e kompletuar tërësisht. Në fillim disa nga PN do të punojnë bashkë me ZPSK, të cilët edhe do të bëjnë trajnime gjatë punës. Ashtu si ZPSK rritet në masë dhe aftësi, prokurorët vendor në njësi do të fillojnë trajnimet për prokurorët tjerë vendor përgjatë Kosovës. Në të njejtën kohë, gjykatësit ndërkombëtar janë zhvendosur në Prishtinë por do të ju lejohet që të gjykojnë rastet në të gjitha rrethet nga aty (e ashtuquajtura qasja e òjuridiksionit

¹⁴¹ Intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, Nëntor 2003.

¹⁴² Intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, nëntor 2003.

¹⁴³ Intervistë me PN, Nëntor 2003.

¹⁴⁴ Intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, Nëntor 2003.

¹⁴⁵ PN duhet të marrin pajtimin e udhëheqësit të divizionit para se të ngrisin aktakuzë apo parashtojnë ankesë. Naarden, supra note 127, fq 732.

¹⁴⁶ Id.

të vetëm). Mbetet të shihet se çfarë ndikimi do të kenë këto masa në ri-fokusimin e drejtimit strategjik dhe ndërtimit të kapaciteteve.

V. KORNIZA LIGJORE

Ligji i aplikueshëm në Kosovë përbën një përzierje të rregulloreve të UNMIK-ut, përfshirë këtu edhe Kornizën Kushtetuese¹⁴⁷ dhe ligjet vendore. Si u përmend më lartë, në fillim autoritetet e UNMIK-ut deklaruan se ligji i aplikueshëm në Kosovë do të jetë Ligji Serb i RFJ-së, i modifikuar për ti plotësuar standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut.¹⁴⁸ Ky vendim i ofendoi rëndë shumë shqiptarë të Kosovës, të cilët refuzuan ta aplikojnë ligjin, që rezultoi në konfuzion të përhapur.¹⁴⁹ Si përgjigje, UNMIK-u nxorri rregullore të reja të cilat shpjeguan se ligji i aplikueshëm në Kosovë do të jetë ligji i aplikueshëm para 22 Marsit 1989, nëse nuk është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut.¹⁵⁰ Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut është drejtëpërdrejtë e aplikueshme në Kosovë dhe aplikimi i saj është në rritje si nga gjykatësit vendor ashtu edhe nga ata ndërkombëtar (edhe pse disa juristë ndërkombëtar kanë komentuar se juristët vendor vetëm do ti referohen dispozitës pa e arsyetuar citimin e tyre).

Juridiksioni i kolegeve ndërkombëtare në Kosovë është ai i gjykatave vendore. Krimet të cilët janë gjykuar kanë qenë pjesë e ligjit vendor. Vetëm gjenocidi dhe krimet e luftës kanë qenë pjesë e Ligjit Penal të Jugosllavisë, dhe në praktikë vetëm krimet e luftës janë gjykuar. Krimet e luftës përbëjnë përafërsisht 10 përqind të rasteve të iniciuara nga prokurorët ndërkombëtar që nga marsi 2003. Së voni, ka patur më pak ndjekje penale për krime të luftës dhe dhunë ndër-etnike pas konfliktit, posaçërisht për dhunën e shaktuar gjatë periudhës 1999 ó 2001.¹⁵¹ Mundësia për ti ndjekur më tej krimet e luftës është kufizuar nga òvështirësitë në mbledhjen e fakteve në periudhën menjëherë pas konfliktit në vitin 2000 ó 2001.¹⁵² Megjithatë, ka patur progres të dukshëm në ndjekjen e krimeve të luftës dhe krimeve etnikisht të motivuara.¹⁵³ Në fundin e 2003, u morr aktgjykimi në rastin e parë vendor për krime të luftës ku të akuzuarit ishin shqiptar të Kosovës ó i ashtuquajhuri rasti *Llapi*. Gjykimi tërhoqi vëmëndjen e gjërë të publikut.¹⁵⁴

Në praktikë, gjykatësit (GJN dhe ata vendor) shpeshherë dështuan ti referoheshin ndonjë burimi ligjor jashtë kodit penal dhe atij të procedurës penale të RFJ dhe Rregulloreve të UNMIK-ut. Këto burime, si janë vendimet relevante të TNPJ, nuk konstituojnë precedent, por mund të përdoren si jurisprudencë. Ato

¹⁴⁷ Korniza Kushtetuese i referohet dhe i bën drejtëpërdrejtë të aplikueshëm në Kosovë disa instrumente të drejtave të njeriut, përfshirë këtu Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut, Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (me protokole), Paktin ndërkombëtar mbi të Drejtat politike dhe Civile (me protokole), Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventën mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Femrave, Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve. Kartën Europiane për Gjuhët e Minoriteteteve, dhe Kornizën e këshillit të Europës për Mbrojtjen e Pakicave.

¹⁴⁸ Rregullorja e UNMIK-ut 1999/1.

¹⁴⁹ Id.

¹⁵⁰ Rregulloret e UNMIK-ut 1999/24 dhe 1999/25.

¹⁵¹ òdështimi për të mbrojturò supra note 33, fq 5.

¹⁵² UNMIK, òFokusi Kosovë,ò Shkurt 2004, fq 10.

¹⁵³ Raporti i SP, S/2004/907, par.17.

¹⁵⁴ Prokurori Publik kundër Latif Gashi, Rrustem Mustafa, Naim Kadriu dhe Nazif Mehmeti. Ishte hera e parë që një gjykatë e administruar nga OKB ti dënnojë dike nga ana e Shqiptarëve për krime të luftës. Të akuzuarit janë akuzuar për krime të luftës në bazë të ligjit të aplikueshëm vendor për vepra të kryera kundër viktimave Shqiptar të Kosovës; nga 26 viktima në aktakuzë, vetëm njeri ka qenë Serb i Kosovës. Katër të akuzuarit janë akuzuar për bashkëpjesëmarrje në paraburgime të paligjshme, torutrë, dhe vrasje të civilëve nga Gushti 1998 deri Qershor 1999. Për përmbledhje të *Rastit Llapi*, shih SMSJ i OSBE-së. òraporti mbi rastin Llapiò, Dhjetor 2003.

rrallë citohen.¹⁵⁵ Në 2002 OSBE-ja i karakterizoi vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës si të shkurta (mesatarja e vendimeve ishte tre deri në katër faqe), arsyetim të dobët ligjor, mungesa e citimeve të autoriteteve ligjore, si dhe me mungesë të interpretimit sa i përket ligjit të aplikueshëm mbi krimet e luftës dhe çështjet e drejtave të njeriut.¹⁵⁶ Si rezultat, OSBE-ja erdhi në përfundim se vendimet e gjykatësve ndërkombëtar ònuk janë mjet i dobishëm për dhënien e udhëzimeve komunitetit ligjor vendor në fushën komplekse të drejtave të njeriut dhe drejtës ndërkombëtare humanitare.¹⁵⁷ Për më tepër, në përgjithësi vendimet nuk publikohen ose ndryshe nuk i dorëzohen dikujt tjetër jashtë palëve, prandaj qasja në to është e limituar.

Disa kanë komentuar që në disa raste GJN dhe PN i përmbahen për së tepërmi traditave të tyre dhe nuk adaptohen në mënyrë adekuate proceseve ligjore në Kosovë. Për shembull, prokurorët nga sistemi anglosakson mund të përpilojnë aktakuza të cilat në sistemin kontinental vlerësohen si shumë të shkurta. Aktgjykimet janë kritikuar si të shkurta, por edhe janë shquar për koncizitet. Për më tepër, dallimet në prejardhjen e PN mund të shpiejnë në mungesën e harmonisë në akuza dhe dënime.¹⁵⁸

Më 6 prill 2004, Kodi i Përkohshëm Penal¹⁵⁹ dhe Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale,¹⁶⁰ të cilët u aprovuan më 6 Korrik 2003, hynë në fuqi,¹⁶¹ duke i zëvendësuar në mënyrë efektive ligjet e aplikueshme penale.¹⁶² Këto kode u hartuan nga grupi punues i përbërë nga një variete e profesionistëve ligjor dhe janë konsoliduar nga zyra ligjore e UNMIK-ut. Këto kode të reja formuan bazën e ligjit penal në Kosovë, së bashku me rregulloret e aprovuara që atëherë. Kodi për të mitur u aprovua më 20 prill 2004, dhe hyri në fuqi po atë ditë.¹⁶³

Kjo òe arritur qenësore e sjell òligjin në Kosovë në harmoni më të madhe me standardet regjionale dhe Europiane dhe siguron konsistencën me principet moderne të drejtës ndërkombëtare, në veçanti drejtën ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.¹⁶⁴ Kodet e reja sjellin reformën përmbajtësore ligjit të procedurës në Kosovë, për shembull, inkorporojnë veprat penale në të drejtën ndërkombëtare dhe deliktet seksuale, e rrisin efikasitetin e procedurës (duke e ndarë përgjegjësinë në procedurën para gjykimin), e rrisin mbrojtjen e të drejtave të akuzuarit, posaqërisht gjatë paraburgimit, dhe e forcojnë fuqinë e prokurorit. Pa marrë parasysh disa ankesave mbi hartimin dhe zbrazëtitrat, kodet në përgjithësi janë pranuar si një përmirësim i sistemit të vjetër, në të cilin janë aplikuar dispozita nga instrumente të ndryshme ligjore.¹⁶⁵

¹⁵⁵ Rasti kundër Momcillo Trajković (Serb nga Kosova). Vendimi u marr me shumicë ndërkombëtare. Rasti kundër Qedomir Jovanović dhe Angjellko Kollashinac. Të dy të akuzuarit janë Serb nga Kosova. Aktgjykimi i marr me shumicë ndërkombëtare.

¹⁵⁶ Raporti i OSBE-së Shtator 2002, supra note 72, fq 48.

¹⁵⁷ Id.

¹⁵⁸ UNMIK, Fokusi në Kosovë, supra note 152, fq 8.

¹⁵⁹ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26, mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, e përmirësuar nga Rreg. E UNMIK-ut 2004/19, 16 ershor 2004.

¹⁶⁰ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25, mbi Kodin e Përkohshëm të Procedurës penale të Kosovës.

¹⁶¹ Supra note 159 dhe 160. Të dy rregulloret janë nxjerrë më 06 Korrik 2003.

¹⁶² Komunikata për shtyp e UNMIK-ut, UNMIK/PR/1161, òFjalimi i ZPSSP-së/Shtylla I Jean ó Christian Cady në seminarin mbi òLuftimi i krimin me kodin e ri penal ò në IGJK, 5 prill 2004, shih në www.unmikonline.org/press/2004/press/pr1161.pdf.

¹⁶³ Rregullorja e UNMIK-ut 2004/8.

¹⁶⁴ Id.

¹⁶⁵ SMSJ i OSBE-së, òShqyrtimi i Sistemit të Drejtësisë Penale, ò supra note 2, thotë, òPas viteve të hartimit dhe ri hartimit, një set plotësisht i reviduar i kodeve penale hyri në fuqi më 6 Prill 2004. Kodet i kanë problemet e veta në kuptim të stilit të draftimit, jo konsistencës dhe lacunae, por pavarësisht kësaj janë një zhvillim i mirëseardhur. Sigurisht theksi i kodeve në aplikimin e standardeve ndërkombëtare të drejtave të njeriut e dërgon një mesazh të rëndësishëm. Me ndihmën e vendimeve të guximshme gjyqësore që interpretojnë dhe zbatojnë ligjin, shpresohet që kodet e reja do të zhvillohen në një instrument më të rafinuar gjyqësor (13).

Kodet e reja e transformojnë strukturën penale në një sistem akuzator në natyrë dhe shumë nga juristët vendor shprehin krenari për një kod òmë Europeanò i cili nuk ka lidhje me Serbinë.¹⁶⁶ Si u përmend, Kodet përmbajnë një numër të karakteristikave të reja, duke përfshirë pranimin e fajësisë dhe marrjen kryqëzore në pyetje gjatë gjykimit. Mirëpo, ka shqetësime të përhapura mbi mungesën e trajnimit për këtë ndryshim dramatik në gjykatat vendore. Karakteristikat si pranimi i fajësisë dhe marrja kryqëzore në pyetje janë të huaja për juristët në Kosovë, të cilët janë trajnuar në traditën e sistemit kontinental, si dhe GJN që vinë nga ai sistem.

Veç kësaj, Kodi i ri i Procedurës Penale poashtu si risi ka përdorimin e audio dhe video inçizimeve në fazën e hetimeve dhe gjatë gjykimit. Kodi po ashtu parashih transferin e qytetarëve të Kosovës të cilët kërkohen nga juridiksionet e huaja, edhe pse kjo dispozitë duhet të përmbushet në bazë të marrëveshjes bilaterale me shtetin që kërkon transferin. Deri tani, UNMIK-u ka nënshkruar marrëveshje specifike ad hoc për transferin e qytetarëve të Kosovës në Norvegji dhe në Mbretërinë e Bashkuar.

VI. MBROJTJA DHE ÇËSHTJET E GJYKIMIT TË DREJTË

Ekipet e mbrojtjes në rastet me GJPN janë të përbëra zakonisht nga avokat vendor. Ata paguhën nga Departamenti i Administratës Gjyqësore e cila është pjesë e Ministrisë së Shërbimeve Publike (MSHP). Për disa raste të ndieshme, si ato kundër oficerëve të lartë të UÇK-së, janë mbledhur fonde private për të angazhuar avokatët më të mirë. Dhjeta avokatë shqiptar dhe serb janë angazhuar në ato raste. Një karakteristikë e sistemit të Kosovës është se avokatët vendorë u desht të òngrisin nivelinò për tu gjetur në ato situata. Shumë vëzhgues flasin për përmirësime në aftësinë e avokatëve vendor, të cilët janë duke ju përshtatur natyrës akuzatore të gjyqësorisë, në ballafaqim me PN dhe me kodin e ri.

Kualiteti i avokatëve mbrojtës po ashtu është ngritur me ndihmën e QRMP, një OJQ e cila ka qenë e përbërë nga avokatë të huaj dhe vendor me mbështetje nga OSBE-ja. QRMP dha asistencë të drejtëpërdrejtë ligjore në rastet e krimeve të luftës, përfshirë këshilla dhe asistencë në raste nga avokatët e huaj. Gati të gjithë avokatët serb dhe shqiptar komentuan mbi vlerën e trajnimeve dhe burimeve për përpjekjet e tyre. Mirëpo, edhe pse QRMP në fillim u mendua që ta ngrisë nivelin e avokatëve vendor, në mungesë të fondeve ajo i reduktoi programet e saj.

Avokatët mbrojtës mund të paguhën privatisht nga klientët e tyre, por kur ata caktohen nga gjykata ose *ex officio*, avokatët paguhën maksimum 250 Euro në muaj, pa marrë parasysh se sa orë kanë punuar.¹⁶⁷ Pagesat për *ex officio* avokat shpeshherë vonohen. Për më tepër, për shkak se pagesa e ka maksimumin e saj, nuk ka shtytje për avokat vendor që ti kushtojnë më tepër orë pune rasteve të tyre.¹⁶⁸ Nuk ekziston sistemi i ndihmës juridike, dhe përgjegjësia për themelimin e një sistemi të tillë do të duhej të bie mbi Ministrinë e Drejtësisë, që duhet të fillojë punën në 2006.

Pa marrë parasysh përmirësimet të cilat janë arritur me hyrjen në fuqi të kodeve të reja dhe demonstrimin e efektit të përfshirjes së ndërkombëtarëve, respekti për të drejtat e të akuzuarit mbetet shqetësues. Komentatorët tregojnë se të akuzuarve ju mohohet e drejta për të kundërshtuar vendimet mbi paraburgimin,¹⁶⁹ për tu shmangur paraburgimit të zgjatur,¹⁷⁰ e drejta për gjykim në kohë të arsyeshme,¹⁷¹

¹⁶⁶ Disa juristë Shqiptar e kanë përshkruar këtë si një përgjigje ndaj kërkesave vendore, deri sat ë tjerët e ndien vetën të përjashtuar nga procesi.

¹⁶⁷ Intervistë me avokat mbrojtës Shqiptar, Nëntor 2003; intervistë me avokat mbrojtës Serb, Nëntor 2003.

¹⁶⁸ Për diskutim të mëtejshëm shih SMSJ i OSBE-së, òShqyrtimi i Sistemit të Drejtësisë Penale, òsupra note 2, fq 72.

¹⁶⁹ OSBE-ja ka vërejtur mungesën e arsytimit të duhur në vendimet mbi paraburgimin, mbi zgjatjen e paraburgimit, dhe ankesave ndaj vendimeve mbi paraburgimin në shumë raste të monitoruara edhe pse ligji parashih ndryshe. Raporti i OSBE-së Dhjetor 2004, fq 16, 18, dhe 23-24.

dhe në mbrojtje efektive.¹⁷² Koha e fillimit të zgjatjes së paraburgimit të dyshuarit nuk është uniforme, pasi që kodet e reja nuk janë të qarta në pikënisjen e zgjatjeve të paraburgimit.¹⁷³ Dispozitat e *habeas corpus* të cilat janë pjesë e kodit të ri rrallë përdoren për të kundërshtuar paraburgimin.¹⁷⁴ Gjykimet po ashtu janë shtyer për shkak të mungesës së dëshmitarëve.¹⁷⁵ Një raport i OSBE-së tregon se në shumë raste arsytimi i vendimeve mbi dënimin si dhe arsytimi i vendimeve të Gjykatës Supreme është i pamjaftueshëm.¹⁷⁶ Edhe pasi që UNMIK-u themeloi Komisionin për Shqyrtimin e Paraburgimit, të përbërë nga ndërkombëtarët, si përgjigje ndaj kritikave për praktikën e paraburgimit,¹⁷⁷ ekzekutimi i paraburgimit akoma nuk e ka mbikëqyrjen gjyqësore.¹⁷⁸ Për shembull, në rastin *Hajra*, të akuzuarit, tani të dënuar, janë mbajtur në paraburgim përgjatë gjithë procedurës e cila zgati 33 muaj.¹⁷⁹ Të gjitha këto tregojnë për nevojën e përmirësimeve të vazhdueshme në sistemin juridik të Kosovës.

VII. ADMINISTRATA GJYQËSORE DHE MBROJTJA E DËSHMITARËVE

Për shkak se gjykatësit ndërkombëtar janë të përfshirë në sistemin e gjykatave vendore, ata i përdorin ndërtesat ekzistuese (me përjashtim të gjykatës së vetme të sigurisë së lartë e cila u ndërtua). Punësimi i stafit ka qenë problematik, posaçërisht në fushat si përkthimi dhe stenografia. Ka një hezitim për përdorimin e përkthyesve vendor, prandaj përkthyesit për gjuhën serbe vijnë nga Kroacia dhe për gjuhën shqipe nga Shqipëria, edhe pse ka dallime të mëdha në dialekte në Kosovë dhe Shqipëri. Procesverbalet e seancave mbahen nga daktilografet dhe kualiteti është i ulët. GJN janë të mbështetur nga DD, i cili e cakton orarin e gjyqësorëve dhe i shpërndan ata sipas nevojës. Kjo duket se është efikase, por para se GJN u zhvendosën në Prishtinë, disa nga ata thanë se udhëtimi u merrte shumë kohë. Një gjykatës tha se disa here u kërkua nga ai të udhëtojë për disa orë vetëm që të merr pjesë në një seancë të shkurtë (p.sh për paraburgim), dhe vërejtje se video konferenca do të kursente kohë dhe mjete.¹⁸⁰ Në përgjithësi, IJSD po ashtu mund të përdorte më tepër staf profesional për të mbështetur GJN.

Për shkak të tensioneve etnike në Kosovë dhe nivelit të krimit të organizuar, UNMIK-u ka kushtuar burime të konsiderueshme mbrojtës së viktimave dhe dëshmitarëve. Rregullorja e UNMIK-ut për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve në procedurën penale përfshin të ashtuquajturit *ödëshmitar anonimë*, që i mundëson gjykatës t'ia rrethojë të veçanta të urdhërojë që identiteti i dëshmitarit të mos i

¹⁷⁰ Sipas UNMIK-ut, nga 13 Qershori 2004, nga 459 të paraburgosur, 127 kanë qenë në paraburgim më tepër se 6 muaj, 98 sish 3-6 muaj, dhe 152 të tjerë 1 ó 3 muaj.

¹⁷¹ Për më tepër, e drejta në gjykim në kohë të arsyeshme është shkelur në shumë raste për shkak të vonësave që janë shkaktuar gjatë marrjes së raportit nga eksperti, të cilët shpeshherë u desht që faktet të presin nga juridiksionet e huaja.

¹⁷² E drejta në mbrojtje efektive është shkelur shpeshherë, duke përfshirë të drejtën e përfaqësimit nga ana e avokatit dhe të drejtën për kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes, si dhe që mbrojtja të kërkojë masa alternative ndaj paraburgimit ose parashtron rrethana lletësuese dhe kërkon dënime alternative. Id. 68-71.

¹⁷³ Id. fq 18.

¹⁷⁴ Id. fq 29. OSBE-ja konsideron se gjykatësit nuk janë të informuar dhe nuk kanë përvojë me ligjin sa i përket kërkesave të *habeas corpus* dhe dispozitave që i japin mundësi gjykatësit të procedurës paraprake që të inicon *ex officio* ndërprerjen e paraburgimit.

¹⁷⁵ Id. fq 31.

¹⁷⁶ Id. fq 39 ó 43. Raporti përfundon se *öGjykata Supreme* nuk e ka përmbushur rolin e saj si interpretues primar i ligjit dhe nuk i ka dhënë gjykatave të ulta udhëzime të duhura rreth dënimeve. *ö* Id. fq 43.

¹⁷⁷ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/18 mbi Themelimin e Komisionit për Shqyrtimin e Paraburgimit për paraburgimet jashtë-gjyqësore të bazuara në Urdhëresat Ekzekutive, 25 Gusht 2001/

¹⁷⁸ Carsten Stahn, *öDrejtesia nën Administratën Transitore: Konturat dhe kritikën e Paradigmës,ö* Houston J.Intl L. Dimër 2005, fq 330.

¹⁷⁹ Aktgjykimi u përpilua më 7 Prill 2005. (Përmbledhja në anglisht në raportin e Nexhat Buzukut, *ö185 vjet burg për 112 Shqiptar të akuzuar në rastin Hajra,ö* publikuar nga gazeta Koha Ditore më 8 Prill 2005, shih në kosovareport.blogspot.com/2005_04_01_kosovareport_archive.html.)

¹⁸⁰ Intervistë me GJN, tetor 2004.

bëhet i njohur mbrojtjes.¹⁸¹ Kjo nuk është praktikë e përgjithshme në tribunale tjera, si janë TPNJ dhe Gjykata Speciale në Sierra Leone. Dispozita e dëshmitarit anonim po ashtu mund të aplikohet për dëshmitarët e mbrojtjes.¹⁸²

Pa marrë parasysh dispozitat për masat e ndryshme mbrojtëse,¹⁸³ mbrojtja e dëshmitarëve vazhdon të jetë sfidë, pasi që frikësimet dhe sulmet janë të shpeshta.¹⁸⁴ Në mes të fundit të vitit 2003 dhe fillimit të vitit 2004, ka patur disa raste të lëndimeve apo të vdekjes të personave të kyçyr në hetimin e krimeve serioze.¹⁸⁵ Frikësimi i dëshmitarëve ose represioni ndaj tyre po ashtu paraqet sfidë për zhvillimin e hetimeve, posaçërisht në rastet e hetimeve të trazirave të marsit 2004.

Rregullorja e UNMIK-ut mbi mbrojtjen e dëshmitarëve është përfshirë në Kodin e ri. Njësia për Mbrojtjen e dëshmitarëve (NJMD), një seksion i specializuar i policisë i cili jep mbrojtje fizike dëshmitarëve, akoma ballafaqohet me vështirësi të mëdha logjistike dhe financiare. Edhe pse ka një sërë masash për fshehjen e identitetit të dëshmitarit, pak nga ato përdoren edhe kur rreziku parashihet.¹⁸⁶ Rekomandimet e OSBE-së, si ato për nevojën e një fushate të informimit të publikut mbi masat mbrojtëse, nuk janë të implementuara plotësisht.¹⁸⁷ Si zhvillim pozitiv mund të ceket se ka patur zhvillime në përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së dëshmitarëve.¹⁸⁸ Për shembull, një seminar trajnues mbi mbrojtjen e dëshmitarëve u organizua nga Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) në bashkëpunim me DD dhe TPNJ, dhe përafërsisht 30 gjykatës vendor dhe ndërkombëtar si dhe prokuror ishin pjesëmarrës.¹⁸⁹ Veç kësaj, në kuadër të Divizionit për Zhvillim Gjyqësor (JDD) u themelua Njësia për Ndhimë Viktimave dhe Avokim (VAAU).¹⁹⁰

VIII. ÇËSHTJET E SHPENZIMEVE DHE EFIKASITETIT

Që nga fundi i vitit 2001, ka patur përafërsisht 80 raste në punë të cilat i janë caktuar apo janë zgjedhur nga personeli gjyqësor ndërkombëtar.¹⁹¹ Në 2002, PN janë marrë me 40 raste me 50 përqind të dënimeve,

¹⁸¹ Rregullorja e UNMIK-ut nr 2001/20, mbi Mbrojtjen e Palëve të Dëmtuara dhe Dëshmitarëve në Procedurat Penale, Shtator 2001, e përmirësuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/1, të datës 24 janar 2002, e cila e zgjat aplikimin e përkohshëm të rregullores 2001/20, dhe Udhëzimi Administrativ 2002/25, i cili implementon Rregullorën 2001/20, 12 Nëntor 2002, neni 4.

¹⁸² Rregullorja 2001/20 mundëson përdorimin e dëshmitarëve anonim edhe nga ana e mbrojtjes, të cilët odo të mbesin anonim për publikun, palën e dëmtuar dhe përfaqesuesin ligjor të saj, palën e dëmtuar si prokuror ose prokurorin privat, o neni 4.1.

¹⁸³ Id. Përveç dëshmitarëve anonimë, Rregullorja mundëson edhe masa tjera për fshehjen e identitetit të dëshmitarit; p.sh. përdorimi i mjeteve për ndryshim të zërit ose për ndryshim të fotografisë, sistem të mbyllur të inçizimit, ose video inçizim, dhënia e pseudonimit, sesione të mbyllura për publikun.

¹⁸⁴ Raporti i OSBE-së, Dhjetor 2004, supra note 169, fq 74-76.

¹⁸⁵ Id.

¹⁸⁶ Id. fq 76. OSBE-ja e ka atribuar përdorimin e rrallë të masave për fshehjen e identitetit të dëshmitarit òmungesës së pranimit për përdorimin e masave mbrojtëse nga ana e policisë, prokurorisë dhe gjykatave, në bashkëveprim me mungesën e pajisjeve teknike në gjykatao.

¹⁸⁷ Id.

¹⁸⁸ Për diskutim të mëtejshëm mbi masat që janë marrë, shih SMSJ i OSBE-së, òShqyrtimi i sistemit të drejtësisë penaleo supra note 2, fq 74.

¹⁸⁹ Trajnimi u mbajt më 17 ó 18 tetor 2003, si përgjigje ndaj rekomandimit nga raporti i OSBE-së, duke mbuluar çështjet e terrorizmit, krimit të organizuar, dhe mbrojtjes së dëshmitarëve. Trajnimi ka përfshirë ligjerata, diskutime dhe raste studimi. Raporti i OSBE-së Dhjetor 2004, supra note 169, fq 76-77.

¹⁹⁰ Për momentin VAAU është duke rekrutuar, trajnuar dhe shpërndarë Avokatët e Viktimave përgjatë regjioneve dhe është duke dhënë ndihmë të shumëllojshme në mbështetje të viktimave të krimit, përfshirë ato që jetojnë në komunitetet pakicë dhe enklava. UNMIK, òShtylla I: Policia dhe Drejtësia, o supra note 73, gq 37.

¹⁹¹ Hartmann, supra note 29, fq 12.

dhe gjysma nga ato dënime janë prishur me ankesë, zakonisht para kolegjeve ndërkombëtare.¹⁹² Numri i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar u rrit nga 11 në gusht të vitit 2001 në 24 (përfshirë 12 gjykatës dhe 12 prokuror).¹⁹³ Në shtator 2005, 27 gjykatës dhe prokuror ndërkombëtar kanë qenë të përfshirë në 60 dhe 44 raste, respektivisht,¹⁹⁴ pra një rënie nga 92 raste në qershor 2004.¹⁹⁵ Më pas, që nga krijimi i Divizionit Penal në kuadër të DD, shkalla e dënimeve është rritur në 96 përqind. Që nga Qershori 2004, Divizioni Penal ka inicuar 305 raste përfshirë trazirat e Marsit 2004 (52 raste), krimet e luftës (38 raste), vrasje (33 raste), korrupsion, armë, terrorizëm, trafikim (të narkotikëve, armëve, femrave dhe të miturve), krim të organizuar, dhe krime tjera serioze.¹⁹⁶ Këto numra janë të krahasueshëm me cilindo sistem tjetër vendor.

Koha e nevojshme për përfundim të rasteve ka qenë e ndryshme. Afatet për rastet para kolegjeve ndërkombëtare janë më të gjata se ato para kolegjeve vendore, por megjithatë janë më të shkurta se para tribunaleve ndërkombëtare. Gjykatësit rrallë përpilojnë aktgjykime të gjata dhe rastet zakonisht kanë të bëjnë vetëm me disa akuza. Sipas zyrtarëve të UNMIK-ut, shumica nga gjykimet me GJPN zgjasin disa muaj, dhe më i gjati ka qenë përafërsisht 6 muaj.¹⁹⁷ Disa gjykatës dhe juristë vendor besojnë se GJPN i trajtojnë rastet shumë më ngadalë se gjykatësit vendor.¹⁹⁸

Edhe pse hyrja në fuqi e kolegjeve të Rreg.64 dhe zgjerimi i autoritetit të PN solli një menaxhim më efikas, grumbulli i lëndëve mbetet i lartë, duke krijuar një barrë të madhe për gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar në Kosovë.¹⁹⁹ OSBE-ja ka vërejtur se gjykatat nuk kanë mundësi të merren me këtë grumbull pa vonesa edhe pse ligji parasheh të drejtën e të akuzuarit për një gjykim në kohë të arsyeshme.²⁰⁰ Ka një numër faktorësh të cilët shkaktojnë vonesa në menaxhimin e rasteve, por faktor i rëndësishëm është vështirësia në sigurimin e prezencës së të akuzuarit, dëshmitarëve, dhe palës së dëmtuar. Për më tepër, gjykatat nuk kanë personel të mjaftueshëm.²⁰¹

Financimi i kolegjeve dhe prokurorisë ndërkombëtare në Kosovë është i ndarë në mes të buxhetit të UNMIK-u, i cili bazohet në kontributin e shteteve anëtare, dhe Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Fondet për IJSD sigurohen nëpërmjet buxhetit të UNMIK-ut. Kjo përfshin rrogat e prokurorëve ndërkombëtar dhe stafin administrativ dhe mbështetës (përkthyesit, procesmbajtësit, dhe zyrtarët ligjor).²⁰² Nuk ishte e mundur të sigurohen të dhënat e sakta nga UNMIK-u ose Departamenti i Operacioneve Paqëruajtëse. Me aprovimin e Buxhetit të UNMIK-ut për vitin 2001-2002 nga Asambleja e Përgjithshme e OKB,²⁰³ burimet financiare të UNMIK-ut janë zvogëluar në masë të madhe,²⁰⁴ që solli në

¹⁹² Intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, nëntor 2003. Veni re se ky numër është më i ultë se sa numri i cituar në raportin e Hartmannit, i cili thotë se deri më Tetor 2002 kolegjet ndërkombëtare janë marrë me 90 raste.

¹⁹³ UNMIK, òShtylla I: Polici dhe Drejtësi, ò Korrik 2004, fq 15.

¹⁹⁴ Raporti Javor i DD, 30 Gusht ò 5 Shtator 2003.

¹⁹⁵ UNMIK, supra note 193, gq 15.

¹⁹⁶ Id. fq 15-16.

¹⁹⁷ Intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, Nëntor 2003.

¹⁹⁸ Intervistë me gjykatës vendor Shqiptar, Nëntor 2003, duke cekur se GJN merren me 3-4 raste të rënda për një vit, derisa gjykatësi vendor merret me 6 raste në muaj të cilët janë përafërsisht të rëndësisë së njejtë.

¹⁹⁹ Schroder, supra note 88, fq 9.

²⁰⁰ Ligji ka afate të caktuara për faza të ndryshme të procedurës. Shqyrtimi kryesor duhet të caktohet Brenda dy muajve pas ngritjes së aktakuzës. Neni 279 LPP, raporti i OSBE-së Mars 2004, fq 10.

²⁰¹ Mungesa e gjykatësve në Zubin Potok dhe Leposaviq, dy gjykata komunale të cilat u hapën në regjionin e Mitrovicës në Janar 2003, është më e theksuar. Që nga Marsi 2004, nuk janë emëruar gjykatësit porot për asnjërin nga gjykatat. Misioni i OSBE-së në Kosovë, SMSJ òShqyrtimi i Sistemit të Drejtësisë penale: Administrimi is ë drejtës në gjykatat komunale ò mbrojtja e dëshmitarëve në procedurat penale.ò Mars 2004, fq 16.

²⁰² Thordis Ignadottir, òFinancimi i tribunaleve dhe Gjykatave penale të ndërkombëtarizuara,ò në Romano et al., supra note 61, fq 283.

²⁰³ A/RES/56/295, 11 Korrik 2002.

zvogëlimin e disa departamenteve dhe fushave funksionale. Kjo ndikoi posaqërisht në DD. Në 2004, buxheti i përgjithshëm për gjykatat e Kosovës ka qenë 17.3 milion Euro, ose përafërsisht 2.1 përqind e buxhetit të UNMIK-ut për vitin 2004.

Si rezultat i mungesave financiare, sistemi juridik në Kosovë akoma vuan nga mungesa e mjeteve për tu marrë me raste në mënyrë efikase. Në mes të tjerave, numri i kufizuar i përkthyesve sjell deri te vonesat në gjykime.²⁰⁵ Veç kësaj, për shkak të kufizimeve logjistike dhe financiare, mjekët e bazuar në Prishtinë nuk kanë patur mundësi të marrin pjesë në shqime në vendin e ngjarjes dhe shpeshherë kanë refuzuar të dëshmojnë në gjykatë.²⁰⁶ Për shkak të mungesës së ekspertëve vendor, dëshmitë forenzike janë dërguar jashtë vendit (Bullgari dhe ndonjëherë në Gjermani) për analizë. Disa raporte të cilat u kthyen shpeshherë ishin të përcipta dhe nuk kishin fuqi provuese. Mirëpo, avokatët vendor e kishin të vështirë ti kundërshtonin raportet për shkak të mungesës së ekspertëve vendor. Problemi posaqërisht ka ndikuar në rastet e krimeve të luftës dhe atyre etnikisht të motivuar.²⁰⁷

Pasi që shumica e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar janë punësuar nga UNMIK-u në nivelin P4 ose P5,²⁰⁸ shpenzimet e përgjithshme do të varen nga ajo se sa janë aktivizuar, edhe pse si mesatare ata e kanë një rrogë vjetore që kalon 100 000 \$ me shtesë të mëditjeve ditore.²⁰⁹ Në cdo rast, mjetet të cilat janë në disponim për komponentën ndërkombëtare të sistemit të drejtësisë mund të konsiderohen se tejkalojnë mjetet që janë në disponim për sistemin vendor. Grupi Ndërkombëtar i Krizave ka cekur se gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar janë ÷tepër të shtrenjtë dhe për momentin nuk kontribuojnë në zhvillimin e kapaciteteve vendore.²¹⁰ Cështja e trashëgimisë diskutohet më poshtë.

IX. MARRËDHËNIA ME TPNJ DHE MEKANIZMAT TJERË TË DREJTËSISË TRANZICIONALE

TPNJ mban autoritetin që të merr cilindo rast që përfshin gjenocidin, krimet e luftës, ose krimet kundër njerëzimit që kanë ndodhur në ish Jugosllavi pas vitit 1991,²¹¹ dhe juridiksioni i tij është i njëkohshëm me ate të gjykatave vendore.²¹² Prokurorët e TPNJ e kanë bërë të qartë, që ata janë duke u fokusuar në kryesit në pozita të larta,²¹³ dhe autoritetet e UNMIK-ut që në fillim u pajtuan me këtë ndarje të punës.²¹⁴ Përveq rastit të Sllobodan Millosheviqit, TPNJ ka inicuar disa raste që merreshin me krimet e kryera në Kosovë,

²⁰⁴ Buxheti për periudhën 1 Korrik 2002 deri më 30 Qershor 2003, u reduktua në 344,966,100 \$ nga 413,361,800, buxheti i vitit të kaluar (A/RES/55/227).

²⁰⁵ Anthony J. Miller, ÷Ndërtimi i Shtetit: Mësimet nga e kaluara dhe sfidat përpara: Adresa kyçe UNMIK: Mësimet nga faza e hershme e ndërtimit të institucioneve, ÷ Neë England L. Rev. vjeshtë 2004.

²⁰⁶ Marshall, supra note 29, fq 127.

²⁰⁷ Për shembull, në rastin Beqiri dhe Sopi, edhe një vjet pas ngritjes së aktakuzës kundër të dyve për tentim vrasje, u zbulua se viktima, për të cilën gabimisht mendohej se është serb nga Kosova, ka qenë i dërguar në spital ku edhe vdiq ditën e nesërme. Spitali nuk i dha këto informata policisë, gjykatës, ose avokatit mbrojtës, dhe aktorët ligjor nuk e përcjellën fatin e viktimës. Marshall, supra note 29, fq 128.

²⁰⁸ Për shkallën më të re të pagesave për stafin profesional dhe të kategorive të larta (nga 1 Janar 2005), shih www.un.org/Depts/OHRM/salaries/allowances/salaries/salaryscale/professional/base0105.xls (së fundi e kontrolluar më 23 Maj 2005).

²⁰⁹ Intervista me zyrtar të UNMIK-ut, Nëntor 2003.

²¹⁰ ÷Gjetja e balancit, ÷ supra note 28, fq 9.

²¹¹ Statuti i TPNJ, nenet 1-5.

²¹² Id. neni 9.

²¹³ Del Ponte, supra note 43.

²¹⁴ Intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, Nëntor 2003.

kundër Sërbëve si dhe kundër UÇK-së.²¹⁵ TPNJ e akuzoi Ramush Haradinajn, në atë kohë Kryeministër i Kosovës, i cili ka qenë shumë i popullarizuar dhe lider i një nga partitë udhëheqëse në Kosovë. Ai u akuzua së bashku me dy ish anëtarë të UÇK-së, Idriz Balaj dhe Lah Ibrahim, për krime kundër njerëzimit të kryer kundër serbëve, romëve, dhe bashkëpunëtorëve të dyshuar të Serbisë gjatë konfliktit. Haradinaj u lirua deri në fillim të gjykimit dhe po ashtu ju lejua të kyçet në aktivitetet politike për aq sa i lejohet nga UNMIK-u, për hir të òpaqës dhe pajtimit.²¹⁶

Zyrtarët e sektorit të drejtësisë në UNMIK e kanë përshkruar marrëdhënien me TPNJ si bashkëpunuese dhe òplotësuese, duke cekur se UNMIK-u rregullisht i ndihmon TPNJ gjatë hetimeve.²¹⁷ Për shembull, rasti *Limaj* filloi në gjykatat e Kosovës, me jurist vendor, dhe më vonë i është dorëzuar TPNJ.²¹⁸ Në pjesën më të madhe, zyrtarët e UNMIK-ut nuk e kanë konsideruar TPNJ si ndërhyrës, por më tepër e mirëpresin çdo ndihmë nga tribunali dhe cekin se TPNJ është i përqëndruar vetëm në rastet e nivelit të lartë.²¹⁹ Së paku një zyrtar i UNMIK-ut tha, se pa marrë parasysh këto, TPNJ nuk jep njoftim paraprak të duhur për veprimet e tij.²²⁰

Për më tepër, shqiptarët e Kosovës ankohen se dënimet të cilat tribunali i jep serbëve janë të lehta, posaçërisht nëse krahasohen me dënimet vendore, dhe po ashtu theksojnë se TPNJ nuk merret me krimet më të rënda që kanë ndodhur në Kosovë.²²¹ Në mënyrë periodike haruesit e politikave në Kosovë kanë diskutuar mbi formimin e komisionit për të vërtetën në Kosovë. Ata shpeshherë e përmendin mungesën e një forumi për pranimin publik dhe pajtimin, si në nivel të lidhshpimit politik ashtu edhe në nivel të komuniteteve. Aspektet historike të konfliktit e bëjnë të vështirë përcaktimin e periudhës të cilin komisioni për të vërtetën duhet ta adresojë. Mirëpo, të tjerët komentojnë se òplagët janë akoma të hapura²²² dhe një aktivist vendor i të drejtave të njeriut i cili punon për një OJQ e cila merret me personat e zhdukur tha se kjo pyetje duhet të presë derisa Kosova të pavarësohet. Prokurorët ndërkombëtar kanë përmendur nevojën për një mekanizëm alternativ i cili do të plotësojë òzbrazëtirën e pandëshkueshmërisë sa i përket rasteve të cilat nuk mund ti gjykojnë. Çështja e personave të zhdukur është prezente gjithmonë në çështjet e drejtësisë tranzicionale në Kosovë. Për dallim nga Bosna, e cila e ka Kolegjin e të Drejtave të Njeriut, Kosovës i ka munguar një institucion i fuqishëm i të drejtave të njeriut që mund të përdoret për çështjet e drejtësisë tranzicionale, përfshirë këtu kthimin e pronës dhe kompensimin.

X. INFORMIMI PUBLIK, PERCEPCIONI PUBLIK, DHE PRONËSIA

Tribunalet ndërkombëtare kanë pranuar rëndësinë e informimit publik në punën e tyre. Ambienti për programin e GJPN ka qenë shumë i vështirë, me politikat nacionaliste në Kosovë dhe pak vend për mendime të moderuara. Mirëpo, në këtë kontekst informimi publik merr një urgjencë të rritur, por nuk ka patur aspak përpjekje lidhur me programin e GJPN. Nuk janë mbajtur takime me qytetarë dhe mbulimi me radio nuk ka qenë i rregullt. Asnjë nga seksionet e UNMIK-ut nuk ndien përgjegjësinë për ta udhëhequr këte. Në kontrast, policia e UNMIK-ut, në ndërtesën e SHPK-së, ka patur përpjekje ekstensive për informim të publikut dhe ka investuar në edukimin publik të tyre dhe përpjekje mediale. Për këte kanë pranuar lavdata si nga serbët ashtu edhe nga shqiptarët.

²¹⁵ Shih aktakuzat në rastin Pavkovic et al., IT-03-70; Milutinović et al., IT-99-37; dhe Limaj et al., IT-03-66, shih në www.un.org/icty/cases/indictindex-e.htm.

²¹⁶ Prokurori kundër haradinaj et al., vendimi i përkohshëm pas kërkesës së prokurorit për ndaljen e vendimit të Gjykatës të datës 12 tetor 2005 në lidhje me kushet e lirimit të parakohshëm për Ramush Haradinaj, 21 tetor 2005.

²¹⁷ Intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, Nëntor 2003.

²¹⁸ Id.

²¹⁹ Id.

²²⁰ Intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, Nëntor 2003.

²²¹ Intervistë me avokat mbrojtës Shqiptar, Nëntor 2003.

²²² Intervistë me kreun e OSBE-së, një avokat mbrojtës Shqiptar dhe zëdhënësin e policisë, Nëntor 2003.

Gjykimet janë të hapura për publikun, dhe zyrtarët e UNMIK-ut thojnë se pjesëmarrja e publikut ka qenë e lartë në gjykimet më të rëndësishme.²²³ Por, shumë nga komuniteti lokal ankohen se aspektet kyce të procedurës kanë qenë të mbyllura.²²⁴ Zyrtarët e UNMIK-ut kanë vlerësuar se mbylljet kanë qenë të nevojshme për të mbrojtur dëshmitarët.²²⁵ Situata e sigurisë po ashtu ka paraqitur një sfidë të vazhdueshme jo vetëm për vëzhguesit, por edhe për pjesëmarrësit. Kjo ka qenë posaçërisht e pranishme pas trazirave të marsit 2004. Për të adresuar këtë problem, DD ka marrë masa për të siguruar qasjen në gjykata.²²⁶ Pas trazirave të marsit 2004, DD po ashtu ka ofruar ndihmë juridike serbëve të Kosovës të cilët janë zhvendosur dhe po ashtu ka bashkëpunuar me policinë e UNMIK-ut për të siguruar transportin e gjykatësve dhe prokurorëve serb të Kosovës, si dhe ka hulumtuar mundësinë e dhëniës së ndihmës juridike për viktimat e dhunës së marsit 2004.²²⁷

DD ka adoptuar politikën e kufizimit të bashkëveprimit me media në Departamentin e Informimit Publik (DIP). Mbulimi i mediave lokale nganjëherë ka qenë i anshëm, dhe shumë nga GJN dhe PN ankohen për sulmet e vazhdueshme në media ndaj tyre si dhe ndaj vendimeve të cilat i marrin. Instituti për Raportimin në Luftë dhe Paqe ka organizuar disa trajnime për mediat lokale. Përfaqësuesit e mediave lokale ankohen se konferencat për shtyp nuk janë të rregullta,²²⁸ dhe thonë se mungesa e kontakteve të tilla e bën sistemin gjyqësor të jetë i padepërtueshëm për mediat dhe publikun, duke e cenuar sundimin e ligjit. Disa nga zyrtarët e UNMIK-ut kanë thënë se janë duke e òhumbur luftën në media, dhe i cekin zhvillimet kyçe të cilat mediat nuk i kanë përcjellur, si janë mungesa e protestave pas vendimeve kundëthënëse në rastin *Llapi* kundër shqiptarëve të akuzuar për krime lufte. Ata thesojnë se mediat lokale i mbahen vetëm interesave speciale, shpeshherë ndezëse, dhe nuk janë shumë të pavarura,²²⁹ fakt që edhe disa nga kryeredaktorët e gazetave e pranojnë.²³⁰

Në një shkallë të konsiderueshme, perceptcionet për sistemin e GJPN janë të ndara përgjatë vijave etnike. Nuk është për të çuditur, pasi që sistemi u inicua për ta luftuar anshmërinë kundër serbëve në gjykatat e Kosovës, që serbët në komunitetin ligjor vendor e përshëndësin kyçjen e aktorëve ndërkombëtar. Kjo është e rëndësishme pasi që serbët e Kosovës në komunitetin ligjor theksojnë se shumica e serbëve e konsideron TPNJ si të anshëm ndaj serbëve.²³¹ Një avokat mbrojtës serb theksoi se sistemi i GJPN është i nevojshëm për shkak të ndarjes dhe armiqësive ndërmjet popullatës shqiptare dhe serbe në Kosovë: ò Ne nuk i besojmë njeri tjetrit. Prandaj krimet ndëretnike nuk mund të shqyrtohen nga gjykatësit të cilët i përkasin cilitdo nga ky grup.ò²³² Ai i citoi vendimet e GJPN për ti liruar disa serbë në rigjykim, së bashku me ngritjen e aktakuzave për krime lufte kundër shqiptarëve etnik, si të rëndësishëm për ndërtimin e besimit të serbëve në sistem.²³³

²²³ Intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, Nëntor 2003; shih po ashtu intervistë me avokat mbrojtës Serb, Nëntor 2003.

²²⁴ Intervistë me redaktor gazete Shqiptar, Nëntor 2003.

²²⁵ Intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, Nëntor 2003.

²²⁶ Në Shtator 2004, policia e UNMIK-ut e riktheu linjën e autobusëve. Kjo linje shkonte nga Prishtina, Glogovci, Lipjani, Podujeva dhe Obiliqi në bazë javore, me nga një autobus nga secili lokacion çdo ditë. BBC Monitorimi Europë, òPolicia e UNMIK-ut të rifillojë linjën e autobusëve për Serbët nga Kosova,ò 24 Shtator 2004.

²²⁷ Raporti i OSBE-së, Maj 2004.

²²⁸ Intervistë me redaktor gazete Shqiptar, Nëntor 2003.

²²⁹ Intervistë me zyrtar të UNMIK-ut, Nëntor 2003.

²³⁰ Intervistë me redaktor gazete Shqiptar, Nëntor 2003 (thekson se gazetat e kanë një histori problematike të pranimit të fondeve nga partitë, grupet e iteresit, ose grantet, dhe se gazeta e tij dhe disa të tjera janë munduar, pa sukses, që të sigurojnë fonde nga marketingu).

²³¹ Intervistë me avokat mbrojtës Serb, Nëntor 2003.

²³² Id.

²³³ Id.

Shqiptarët e Kosovës kanë tendencë të jenë më negativ gjatë vlerësimit të GJPN. Një çështje është politizimi i zgjedhjes së rasteve, që u diskutua më lartë. Shumë shqiptar të Kosovës në komunitetin ligjor mendojnë se trajtimi i të dyshuarve për krime lufte nga ana e serbëve dhe shqiptarëve nuk është i balancuar. Ata vlerësojnë se shumë serb thjesht nuk janë ndjekur penalisht, edhe ata të cilët janë ndjekur penalisht në fund ose janë liruar ose kanë marrë dënime të buta, përderisa të dyshuarit nga ana e shqiptarëve janë shpallur fajtor dhe kanë marrë dënime të larta.²³⁴ Për shembull, një gjykatës shqiptar ka cituar dështimin e UNMIK-ut që ti ndjek penalisht të dyshuarit pas trazirave serbe në vitin 2000 të cilat lanë të vdekur 13 shqiptar si një shembull i oblllokimit politik të ndjekjeve penale për tu parandaluar trazirat e mëtejme.²³⁵

Pa marrë parasysh kritikën, shumë shqiptar të Kosovës në komunitetin ligjor i mbështesin karakteristikat kyçe të sistemit të GJPN. Përderisa shumë nga ata e shohin anshmërinë e ndërtuar në sistem, nuk akuzojnë si të anshëm individualisht ndonjë GJN apo PN.²³⁶ Shumica e pranojnë prezencën e vazhdueshme të ndërkombëtarëve si të nevojshme dhe të rëndësishme për të siguruar një masë të pavarësisë dhe paanshmërisë dhe për të penguar frikësimet. Ashtu si tha një jurist shqiptar, para GJPN, òpak gjëra ndodhin. Nëse ata nuk do të vinin, do të kishim kaos këtu. Ka qenë një shtytje e madhe.²³⁷ Një gjykatës shqiptar theksoi se, edhe pse gjykatësit vendor do të dëshironin një rol më të madh në vendosjen e ndarjes së rasteve, ata òfuqimisht mbështesin marrjen e rasteve serioze nga ana e GJN.²³⁸ Një arsye e rëndësishme për këtë mbështetje është se GJN i lirojnë gjykatësit vendor nga një presion i madh duke i marrë rastet të cilat është rrezik ti gjykojnë gjykatësit vendor.

Shumë nga komuniteti ndërkombëtar besojnë se programi i GJPN ka qenë i nevojshëm për të parandaluar paraqitjen e anshmërisë dhe frikësimeve në rastet të cilat ndiqen penalisht.²³⁹ Ashtu si tha një ndërkombëtar, ògjykatësit vendor ishin të ballafaquar me presion të madh për të mundur të punojnë vetëm pa iu nënshtruar kërcënimeve ose rryshfetit. Vetëm monitorimi ndërkombëtar asnjëherë nuk do të ishte i mjaftueshëm.²⁴⁰

Mirëpo, ekziston vetëm pak ndikim vendor në çështjet e politikave, pasi që profesionistët vendor nuk kanë qenë prezent në DD deri vonë dhe nuk janë të kyçur në vendimarrje në lidhje me emërimin e gjykatësve ndërkombëtar. Konsultimet me kolegët vendor sa i përket politikave mbeten të kufizuara. Ndërkombëtarët dhe vendorët veprojnë në bota paralele (edhe pse kjo duhet të ndryshojë me krijimin e ministrive të përhershme, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë). Një raport i UNMIK-ut thërret për òzhvillimin e strategjisë gjithpërfshirëse për ndërtimin e kapaciteteve vendore dhe strategjisë dalëse realiste. Juristët Kosovar duhet të jenë pjesë e hartimit të kësaj strategjie.²⁴¹

Një qasje transparente dhe e qëllimtë e informimit publik do ta zbehte këtë dallim të qartë në mes të perceptimeve etnike në lidhje me aktivitetet gjyqësore të UNMIK-ut. Një kyçje më aktive e mediave ò duke përfshirë trajnimet, punëtoritë, qasje në seanca, dhe konferenca të shtypit ò do të zvoglonte anshmërinë politike e cila reflektohet në raportimet e tyre dhe e formon opinionin publik.

XI. TRASHËGIMIA

²³⁴ Intervistë me gjykatës Shqiptar, avokat Shqiptar, dhe redaktor gazete Shqiptar, Nëntor 2003.

²³⁵ Intervistë me gjykatës Shqiptar, Nëntor 2003.

²³⁶ Intervistë me gjykatës Shqiptar, Nëntor 2003 (thekson se i ka parë GJN duke marrë udhëzime nga UNMIK-u se si të vendosin rastin).

²³⁷ Intervistë me jurist Shqiptar, Nëntor 2003.

²³⁸ Intervistë me gjykatës Shqiptar, Nëntor 2003.

²³⁹ Intervista me 3 zyrtar të UNMIK-ut, Nëntor 2003; intervistë me zyrtar të OSBE-së.

²⁴⁰ Intervista me zyrtar të UNMIK-ut.

²⁴¹ Schroder, supra note 88, fq 23.

Në mënyrë abstrakte, mund të prezumohet se kyçja e gjykatësve ndërkombëtar në sistemin ligjor vendor shpie në ndërtim të kapaciteteve dhe trashëgimi. Mirëpo, sistemi i GJPN, u inicua si reagim ndaj nevojave emergjente të gjyqësisë dhe sigurisë, dhe nuk ka qenë i disenjuar rreth vizionit afatgjatë të sistemit. Përfitimet nga trashëgimia ishin pjesë e mendimeve rreth propozimet për KWECC, por kur alternativa e GJPN u paraqit në një binar tjetër si një zgjidhje më imediate të problemeve të paraburgimit dhe dhunës ndëretnike, këto konsiderime u zbehën.

Pavarësisht nga kjo, një sistem i prokurorëve dhe gjykatësve ndërkombëtar të integruar drejtëpërdrejtë në gjyqësinë vendore paraqet rast për simbiozë. Këto përfshinë ekspozimin e komunitetit ligjor kosovar ndaj standardeve dhe profesionistëve ndërkombëtar, dhe me demonstrim të procedurave ligjore të paanshme, ndihmon në ndërtimin e besimit në sistemin juridik të cilin shumica e ka përjetuar si mjet represiv. Mirëpo, kur gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar largohen, çka do të lejnjë pas vete, përveç disa rasteve të gjykuara drejt?

Pengesë e ðefektit të demonstrimit në Kosovë ka qenë perceptioni i ndikimeve nga ekzekutivi i UNMIK-ut në sektorin e gjyqësisë, që e ka sforcuar përshtypjen se gjykatat mund të manipulohen. Për më tepër, ðefekti i demonstrimit po ashtu ka qenë i penguar nga mungesa e ndonjë informimi publik efektiv.

Sukseset në trashëgimi përfshinë faktin se disa nga gjykatësit dhe prokurorët kosovar do të përfitojnë nga puna me kolegët ndërkombëtar të cilët i kanë mësuar ndonjë aftësi. Për shembull, disa gjykatës kosovar e kanë zgjeruar arsyetimin e tyre dhe tani citojnë më tepër autoritete, përfshirë KEDNJ. Një trashëgimi e posaçme mund të jenë aftësitë e përmirësuara të avokatëve mbrojtës. Disa nga gjykatësit kanë komentuar se kanë parë dallim në kualitetin e avokatëve mbrojtës të cilët janë marrë me raste me ndërkombëtar. Mirëpo, potenciali për zhvillim të plotë të kapaciteteve do të pengohet nga mungesa e mandatit për GJPN dhe në fakt, si u përmend, shumë nga PN punojnë vetëm, me disa përjashtime. Për më tepër, barriera e gjuhës mbetet si pengesë e madhe. Trajnimi është në juridiksionin e Shtyllës III të UNMIK-ut, pra OSBE-së dhe IGJK, por GJPN kanë patur vetëm përfshirje të limituar, duke cituar mungesën e kohës.

Një sukses më i madh është SHPK, një nga institucionet kosovare më shumëetnike. Në disa nga fushat më të rëndësishme të DD, janë premtuese zhvillimet të cilat janë duke u ndërmarrë është krijimi i Njësisë Speciale për Krime, operacioni i përbashkët i policisë dhe Divizionit Penal. DD është duke i trajnuar oficerët vendor të policisë për përdorimin e mjeteve të reja, të teknikës së fundit, për vëzhgim të cilët do të zvoglojnë nevojën për dëshmitarë (të cilët nuk mund ti mbrojnë). Gjatë vitit të ardhshëm, DD mendon të përcjellë shembullin e policisë duke ndërtuar një ekip shumëetnik, elit, i cili mund të zhvillojë hetime komplekse penale, posaçërisht rreth krimit të organizuar dhe korrupsionit.

XII. PËRFUNDIM

Ekziston pajtimi i përgjithshëm se GJPN duhet të qëndrojnë në Kosovë edhe pas largimit të pjesës më të madhe të stafit ligjor të UNMIK-ut në qershor 2006. Një pyetje kyçe është shkalla në të cilën gjykatësit dhe prokurorët vendor mund të marrin përgjegjësitë për të gjitha rastet. Një indikacion i kësaj mund të jenë veprimet e gjyqësorit pas trazirave të marsit 2004. Sjellja para drejtësisë e atyre që janë përgjegjës për dhunën e shkaktuar mbetet prioriteti i sundimit të ligjit në Kosovë.²⁴² Gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar janë marrë me rastet më të ndërlikuara lidhur me trazirat, përfshirë djegjet e shtëpive të

²⁴² Raporti i SP (S/2005/88), fq 24.

serbëve, kishave, dhe manastirëve, vrasjeve dhe dhunës ndaj policisë.²⁴³ Mirëpo, me shumicën e rasteve ó më tepër se 200 ó është marrë gjyqësia vendore.²⁴⁴

Nje raport i OSBE-së e jep një vlerësim të performansës së tyre, duke ardhur në përfundim se ka patur vështirësi në mbledhjen e fakteve që ka buruar nga frikësimi i dëshmitarëve dhe hezitimi i tyre për të dëshmuar, efektet e zhvendosjës dhe humbja e deshmive fizike. Kjo rezultoi në numër të vogël të rasteve gjyqësore, përfshirë edhe 95 lirime nga akuza nga 426 raste, dhe vonesa të dukshme në 110 raste të cilët akoma presin përfundimin. Po ashtu, shumë të pandehur janë akuzuar në mënyrë jo adekuate, marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë janë përdorur në mënyrë jo të rregullt, që rezultoi në dënime të buta në shumë raste. Në përgjithësi, OSBE-ja ka gjetur se ósistemi juridik ka dështuar të dërgojë një mesazh të fuqishëm popullatës për dënimin e këtij lloji të dhunës.ó²⁴⁵ Kjo tregon që mbetet punë për tu bërë në gjyqësinë vendore para se ajo të jetë e gatshme të pranojë përgjegjësi të plotë për çdo lloj krimi. Pyetja është se kur do të bëhet kjo, dhe nga kush.

UNMIK-u ka dorëzuar shumë nga kompetencat e tij organeve vendore. Sa i përket gjyqësisë, Grupi Punues i UNMIK-ut për Sundimin e Ligjit asiston në ekzekutimin e transfereve të fuqive nga UNMIK-u në Institucionet e Kosovës, si pjesë e Planit Kosovar për Implementimin e Standardeve. Në të njëjtën kohë, PSSP-ja akoma mban autoritet të gjërë legjislativ dhe ekzekutiv në fushën e zbatimit të ligjit dhe drejtësisë. Që nga shtatori 2005, UNMIK-u transferoi përgjegjësitë në 13 Ministri qëndrore të Institucioneve të përkohshme të Vëtëqeverisjës (IPVQ), përfshirë Kuvendin, Kryeministrin, dhe Kryetarin e Kosovës. Por Korniza Kushtetuese transferoi vetëm një numër të kufizuar të përgjegjësisë në fushën e gjyqësisë IPVQ-së, si janë pjesëmarrja në emërimet gjyqësore, organizimi dhe mbarëvajtja e gjykatave, dhenia e burimeve materiale gjyqësisë, dhe emërimi, trajnimi, disiplina, dhe shkarkimi i stafit ndihmës të gjykatave.

Ministritë e Kosovës akoma nuk përfshijnë Ministrinë e Drejtësisë, edhe pse planet për një ministri të tillë, si dhe ministrinë e punëve të brendshme, janë në fazë të avansuar të konsiderimit nga UNMIK-u. Ministria e Drejtësisë, si u propozua, do të ketë kompetenca të kufizuara, duke përfshirë çështjet e qasjes në drejtësi, udhëheqjen e programit të gjykatave ndërlidhëse, mbrojtjen e viktimave të dhunës familjare dhe trafikimit, ndihmën juridike, pak administratë, dhe hartimin e ligjeve që kanë të bëjnë me gjyqësinë. Detyrat tradicionale të ministrisë do të ndahen në mes të DD, i cili është përgjegjës për politikën strategjike dhe vendimet ligjore substanciale, dhe DAGJ që udhëhiqet nga Kosovarët, nën MSHP, që do të jetë përgjegjës për rolin ekzekutiv në administratën e sistemit gjyqësor vendor. Përfundimisht, UNMIK-u do të duhet të dorëzojë përgjegjësitë e DD në IPVQ. Për momentin parashihet që Ministria e Drejtësisë do të krijohet më 2006 dhe përgjegjësitë do të dorëzohen.²⁴⁶ Por kjo nuk është detyrë e lehtë, për shkak se nuk ka vendor të trajnuar që mund të i marrin këto përgjegjësi.

Në fund të vitit 2005, DD i punësoi përafërsisht 50 profesionistë vendor dhe është në proces të rekrutimit të mëtejshëm. Edhe pas dorëzimit, parashihet se UNMIK-u mund ta luajë një rol mbikëqyrës dhe monitorues, posaçërisht në lidhje me sektorin e drejtësisë. KGJPK, një etnitet i pavarur i emëruar nga PSSP-ja dhe që përbëhet nga anëtar vendor dhe ndërkombëtar, shërben si organ këshillëdhënës në çështjet që kanë të bëjnë me emërimin, shkarkimin dhe disiplinimin. UNMIK-u dhe KFOR-i po ashtu e kanë themeluar JSECG për të shërbyer si oforum për konsultim në mes të UNMIK-ut dhe aktorëve kryesor në zhvillimin e një sektori modern dhe përgjegjës të gjyqësisë që do të mund ta mbajë vetën edhe pas

²⁴³ BBC Monitoring Europe, óKosovë: Prokurorët Ndërkombëtar merren me rastet më të rënda të trazirave të Marsit,ó 17 Qershor 2004. Që nga Qershori 2004, PN kanë hetuar 52 raste të cilët janë cilësuar si më të rënda.

²⁴⁴ BBC Monitoring Europe, supra note, fq 55.

²⁴⁵ SMSJ i OSBE-së. óKosova: Përgjegjja e Sistemit të Drejtësisë ndaj Trazirave të marsit 2004.ó Dhjetor 2005.

²⁴⁶ Intervistë me zyrtar të lartë të UNMIK-ut, Nëntor 2003.

tërheqjes së komunitetit ndërkombëtar.ö Mirëpo, asnjë nga këto mekanizma nuk është posaçërisht i fuqishëm.

Duke i konsideruar vonesat në fillimin e këtij procesi, tani duket se nuk ka kohë të mjaftueshme për trajnim adekuat dhe mentorim të rekrutëve vendor para se UNMIK-u të fillojë tërheqjen nga Kosova ó për shkak të mungesës së kohës por edhe për shkak të mungesës së kapacitetetve ndërkombëtare të cilët janë të stërngarkuar me punë.²⁴⁷ Për shkak të mungesës së planifikimit, dhe posaçërisht në Shtyllën I, OKB mund ta lë Kosovën me një Ministri të Drejtësisë e cila është e dobët si dhe pa burime të duhura për tu përgjigjur sfidave të cilat e presin.

Një raport autoritativ i cili është përgatitur përpara diskutimeve të statusit përfundimtar ka ardhur në përfundim se sistemi i GJPN duhet të mbetet. Raporti i fundit i të Dërguarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovë përfundon se ósistemi i drejtësisë në Kosovë në përgjithësi konsiderohet si më i dobëti nga institucionet Kosovare.ö Ky raport citon problemet e solidaritetit klanor dhe familjar, frikësimin e dëshmitarëve, zbatimin e ligjit dhe zyrtarët ligjor, dhe pasojat gjithpërfshirëse të krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe gjen se:

Gjyqësia e Kosovës dhe policia janë institucione të brishta. Transferi i mëtejme i përgjegjësive në këto fusha duhet, prandaj të, konsiderohet me kujdesí [D]o të ketë nevojë për prezencë të vazhdueshme të policisë ndërkombëtare në rastet e ndieshme. Prezenca e vazhdueshme e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar do të jetë e nevojshme për tu marrë me rastet e krimeve të luftës, krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe në rastet e rënda ndër-etnike. Reduktimi i tanishëm i numrit të gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar është i hershëm dhe duhet urgjentisht të ri-konsiderohet. Rezultati i këtyre reduktimeve mund të jetë humbja e kredibilitetit në sistemin gjyqësor dhe humbja e besimit nga popullata në përgjithësi dhe nga pakicat në veçanti. Ka pak arsye për tu besuar se gjykatësit dhe prokurorët vendor do të jenë në gjendje të përmbushin në të ardhmën e afërt funksionet që tani ndërmirren nga personeli ndërkombëtar.²⁴⁸

Mirëpo, a do të ndikojë mbajtja e GJPN në rritjen e varshmërisë së sistemit gjyqësor në Kosovë nga komuniteti ndërkombëtar? Për më tepër, a janë sfidat me të cilat përballet Kosova në lidhje me tranzicionin nga konflikti dhe dhuna e deri te krimi i organizuar, unike? Shumë nga këto sfida janë pjesë e shoqërive të post ó konfliktit, dhe OKB nuk mund të vazhdojë të jetë si zëvendësim për kapacitetet ligjore në të gjitha këto instanca.

Në fund të vitit 2005, të gjithë GJPN janë transferuar në Prishtinë dhe pritet që nga kryeqendra të punojnë në raste. Trendi pra shkon kah centralizimi i procesit. Disa mendojnë që koncentrimi i kapaciteteve ndërkombëtare në Prishtinë do ti vendosë GJPN në pozitë më të mirë për të bërë një kontribut konkret për të lënë diçka mbrapa. A do të ndodh kjo mbetet të shihet dhe mësimet tjera nga përvojat në Kosovë mund të elaborohen më vonë.

²⁴⁷ Për pjesën më të madhe, DD ka filluar të zvoglohet duke mos i plotësuar vendet e lira kur dikush nga stafi largohet nga Koaova. Kjo ka lënë mungesa në disa seksione të DD, pasi që stafi ndërkombëtar i OKB kërkon punë alternative para dorëzimit të përgjegjësive. Një përjashtim nga kjo politikë janë gjykatësit dhe prokurorët, postet e zbrazëta të të cilëve akoma zëvendësohen.

²⁴⁸ Letra me datë 7 Tetot 2005, nga Sekretari i Përgjithshëm e adresuar Kryesuesit të Këshillit të Sigurimit, S/2005/635, si shtojcë óShqyrtimit Gjithpërfshirës të Situatës në Kosovë,ö par.35, 40.